

## P ë r m b a j t j a

Hyrje.....	2
Buxheti dhe Financa.....	3
Ekonomi Bujqësi Pylltari.....	10
Prokurimi.....	16
Administrata.....	25
Arsimi.....	29
Shëndetësi dhe përkujdesje sociale.....	32
Shërbime Publike.....	35
Urbanizmi dhe Mbrojtja e Mjedisit .....	37
Mbrojtje dhe Shpëtim.....	40
Kulturë Rini dhe Sport.....	44
Inspekcioni.....	56
Gjeodezi Kadastër dhe Pronë.....	62
Zyra për informim.....	62
Zyra për Integritim Evropiane.....	64
Zyra ligjore.....	64
Sekretaria e kuvendit.....	65
Zyra Lokale e Komuniteteve .....	65

## Hyrje

Ky raport paraqet aktivitetet dhe punën njëvjeçare të Kryetarit të komunës dhe qeverisë komunale për v. 2015 siç është përcaktuar me dispozitat e ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e komunës si dhe planin e punës së kuvendit të komunës për v.2015. Raporti përmban pjesën hyrëse të tij, punët e kryera në fushën e buxhetit dhe financave, investimet në projekte të ndryshme, punët që janë kryer edhe në aspektin e zhvillimit ekonomik të komunës, prokurimit publik, shërbimet publike, urbanizmit dhe mbrojtjes së mjedisit, gjeodezi dhe kadastrit, inpekcionit, kulturë rini dhe sport, emergjencës, administratën, arsim, shëndetësi dhe mbrojtje sociale , zyrës ligjore, zyrës së kryetarit, zyrës për integrimi evropiane, zyrës për informim, zyrës lokale të komuniteteve etj.

Objektivat e realizuara: realizimi i projekteve të planifikuara për v. 2015, mirëmbajtja e rrugëve dhe gjelbërimeve, ndërtimi i hapësirave shkollore, përkrahja e aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive, mbështetja financiare e rasteve me sëmundje të rënda, mbështetja financiare e shoqatave të dalura nga lufta e UCK-së, shoqata e të burgosurve politik, shoqata e martirëve të lirisë, shoqata “Handikos” etj., ngritja e performancës në punë në administratën komunale, ngritja e cilësisë në fushën e arsimit, ndërtimi i objekteve shkollore, rritja e buxhetit dhe subvencionimi i fermerëve, transparenca komunale me, bashkëpunimi me Policinë e Kosovës, KFOR-in në aspektin e sigurisë, bashkëpunimi me institucionet qendrore të Republikës së Kosovës sidomos me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal në aspektin e përcjelljes së mbikëqyrjes së ligjshmërisë së akteve të miratuara në kuvend, ngritja e performancës në mbrojtjen e pyjeve në raport me vitin e kaluar, edhe pse nuk është arritur qëllimi i dëshiruar në këtë drejtim.

Objektiva në proces të realizimit : Regjistrimi i pronës komunale – është ende në proces, realizimi i të hyrave vetanake – nuk është realizuar në tërësi planifikimi buxhetor, përkujdesja ndaj popullatës në gjendje të rëndë sociale.

Aktivitetet kryesore të Kryetarit të Komunës : mbajtja e takimeve të rregullta javore me drejtor të drejtorive në të cilat janë shqyrtuar kërkesat me shkrim të qytetarëve dhe raportet javore të drejtorive, takimet me qytetarë në të cilat janë trajtuar kërkesat e tyre pastaj tubimet me qytetarë – dy tubime të rregullta, si dhe 13 takime tjera me qytetarë përkatësisht dëgjime buxhetore, po ashtu propozimet për prioritetet e projekteve kapitale për vitin 2016, takimet e ndryshme me zyrtar në nivel qendror, përfaqësues KFOR-it, OSBE-së, shoqërisë civile, mbikëqyrja e zbatimit të akteve të miratuara në Kuvendin e Komunës, mbikëqyrja e realizimit të projekteve kapitale te komunës, etj.

Në protokollin e zyrës së kryetarit kanë qenë të evidentuara (protokolluara) gjithsejtë 1318 lëndë, prej të cilave: 447 kërkesa nga institucionet lokale, ndërmarrje publike, shoqëria civile, organizata dhe shoqata të ndryshme, individ – nëpunës civil dhe qytetarët, institucionet qendrore, organizatat e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare etj. (të gjitha janë shqyrtuar dhe proceduar konform ligjit dhe akteve tjera) janë nxjerrë 575 vendime nga kryetari i komunës, janë lëshuar 14 urdhëresa, janë pranuar dhe analizuar 24 raporte nga drejtoritë komunale, komisionet e ndryshme, auditorët etj., 20 autorizime si dhe 238

lëndë tjera të natyrave të ndryshme (propozime, njoftime, përgjigje në kërkesa të organeve qendrore, marrëveshje, informata të ndryshme, rekomandime, etj.

Për kuvendin e komunës janë propozuar për shqyrtim dhe miratim: 11 draft rregullore, 4 plane, 7 strategji dhe 85 vendime

Në vijim do të pasqyrojmë në mënyrë të detajuar punët që janë kryer brenda v. 2015, nga Kryetari – qeveria komunale, (realizimi i investimeve, realizimi i buxhetit, si dhe punët dhe aktivitetet tjera sipas resorëve).

## **Buxhet dhe Financa**

### Planifikimi i buxhetit për vitin 2015 është si në vijim

Në këtë raport paraqitet mënyra e realizimit të buxhetit sipas kategorive ekonomike si dhe programeve buxhetore komunale dhe krahasimet e vitit 2015 me vitin 2014, pastaj, realizimi i të hyrave vetjake komunale sipas burimeve, shpenzimet e krijuara sipas kategorive ekonomike, përqindja e realizimit të buxhetit për vitin 2015.

Kategoritë ekonomike	Ndarjet Buxhetore sipas SIMFK	Pagesat 2014	Pagesat 2015	Progresi 2015	Realizimi 2015
Paga dhe mëditje	9,402,921.56	8,497,772.64	9,376,097.76	110.34	99.71 %
Mallra dhe shërbime	1,534,508.77	1,204,038.48	1,375,656.19	114.25	89.65 %
Shpenzime komunale	247,140.85	194,143.99	237,420.67	122.29	96.07 %
Subvencione dhe transfere	227,071.76	242,980.00	211,078.75	86.87	92.96 %
Shpenzime kapitale	4,389,646.26	3,964,919.49	3,716,731.89	93.74	84.67 %
Gjithsej pagesat	15,801,289.20	14,103,854.60	14,916,985.26	105.77	94.40 %

Buxheti fillestar paraqet Buxhetin e miratuar me Ligjin e buxhetit, Buxheti fillestar ka qenë 14,625,419 , këtij buxheti i shtohen të hyrat e bartura të cilat janë në vlerë 493,421.27 €, donacionet të cilat për vitin 2015 kanë qenë 482,702.73 € si dhe 199,746.20 € është ndryshimi sipas vendimit të Qeverisë 12/64 “Kontigjenca për paga për pagesën e përvojës së punës” Buxheti final është 15.801.289.20 € ose shprehur në përqindje 8% më shumë se Buxheti i planifikuar. Krahasuar me vitin 2014 buxheti është realizuar për 5.77 %, kurse realizimi i buxhetit për vitin 2015ka qenë 94.40%

PËRMBLEDHJA E SHPENZIMEVE SIPAS DREJTORIVE

Përshkrimi	Kodi	Periudha Raportuese( Janar-Dhjetor-2015)		
		Buxheti	Shpenzimi	%
Zyra e Kryetarit	160	232,425.22	227,138.34	98%
Administrata dhe personeli	163	290,884.01	289,848.77	100%
Inspektimet	166	91,412.04	91,300.93	100%
Prokurimi	167	33,872.59	33,833.49	100%
Zyra e Kuvendit Komunal	169	123,442.31	123,442.31	100%
Buxheti dhe financat	175	172,400.32	172,066.53	100%
Shërbimet publike, Mbrojtja civile dhe emergjenca	180	1,583,930.07	1,422,279.00	90%
Zyra lokale e komuniteteve	195	49,798.53	49,307.70	99%
Bujqësi, pylltari, zhvillimi rural	470	743,565.41	632,772.32	85%
Gjeodezi dhe Kadastër	650	239,857.84	208,058.22	87%
Planifikimi urban dhe mjedisi	660	1,852,712.77	1,685,503.73	91%
Shëndetësia primare	730	1,871,930.26	1828,088.65	98%
Shërbimet sociale rezidenciale		97,650.96	97,250.64	100%
Kulturë, rini, sport	850	354,531.50	320,862.20	91%
Arsimi	920	7,764,129.59	7,735,232.43	100%
TOTALI		15,801,289.20	14,916,985.26	94%

Shuma e shpenzuar për mallra dhe shërbime është si në tabelën në vijim,

13	Përshkrimi i shpenzimit	Janar Dhjetor 2015	Janar Dhjetor 2014
13130	Shpenzimet e Udhëtimit zyrtar brenda vendit	90.00	1,538.80
13140	Shpenzimet e Udhëtimit zyrtar jasht vendit	6,027.40	2,935.80
13141	Meditja e udhimit zyrtar jashtë vendit	12,093.00	10,532.07
13310	Shpenzimet për internet	102.00	240.00
13320	Shpenzimet e telefonisë mobile	29,032.69	16,014.18
13330	Shpenzimet postare	7,779.52	7,378.82
13410	Shërbimet e arsimit dhe trajnimit	6,380.00	
13430	Shërbime të ndryshme shëndetësore	4,595.10	2,307.00
13440	Shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënëse	2,045.00	540.00
13450	Shërbime shtypje- jo marketing	4,063.00	
13460	Shërbime Kontraktuese Tjera	618,249.66	531,829.16
13470	Shërbime Teknike	5,258.13	
13480	Shpenzimet për Antaresim	3,329.00	7,987.00
13501	Mobilje (me pak se 1000 euro)	14,706.00	17,062.00
13503	Kompjuterë (me pak se 1000 euro)	11,739.00	4,650.90
13505	Makina fotokopjuese (me pak se 1000 euro)	6,600.00	4,830.00
13509	Pajisje tjera (me pak se 1000 euro)	46,099.94	21,209.07
13610	Furnizime për zyrë	98,087.95	85,255.27
13611	Furnizim me dokumenta bllanko	4,408.39	
13620	Furnizime me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare)	23,909.32	27,365.65
13630	Furnizime mjekësore	38,283.02	35,891.86
13640	Furnizime pastrimi	12,106.92	28,392.96

13650	Furnizim me veshmbathje	10,534.70	13,899.60
13655	Furnizim me preparate kimike	1,891.75	
13660	Akomodimi		455.00
13710	Vaj	693.00	1,911.40
13720	Nafte per ngrohje qendrore	48,286.26	46,149.32
13750	Qymyr	47,652.00	40,720.80
13760	Dru	53,196.50	64,866.00
13770	Derivate per gjenerator	6,365.82	6,872.76
13780	Karburant per vetura	67,654.77	79,150.44
13790	Gas natyror	198.45	
13820	Avans për udhëtime zyrtare	200.00	
13950	Regjistrimi i automjeteve	7,838.44	5,729.00
13951	Sigurimi i automjeteve	10,001.94	9,378.23
13952	Taksa komuale e regjistrimit te automjeteve	400.00	410.00
14010	Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	28,232.80	30,431.45
14020	Mirëmbajtja e ndërtesave	16,378.80	18,898.21
14022	Mirëmbajtja e ndërtesave administrative afariste		141.00
14023	Mirëmbajtja e shkollave	10,594.52	6,678.80
14024	Mirëmbajtja e objekteve shëndetësore	3,009.34	8,292.26
14032	Mirëmbajtja e auto rrugëve lokale		2,427.86
14040	Mirëmbajtja e Teknologjisë Informative	223.40	1,753.38
14050	Mirëmbajtja e mobileve dhe pajisjeve	19,224.61	9,355.20
14060	Mirëmbajtja rutinore	52,810.00	
14210	Reklammat dhe konkurset	1,766.00	4,959.37

14220	Botimet e publikimeve	759.00	352.00
14230	Shpenzimet për informim publik	5,720.60	5,076.00
14310	Drekat zyrtare	10,786.60	23.382.10
14310	Shpenzimet e përfaqësimit	12,181.00	12.340.63
14410	Shpenzime-vendimet e gjykatave	640.90	4,436.13
14420	Pagesa-Neni 39.2 LMFPP	3,429.95	
<b>13 TOTALI PËR MALLRA DHE SHËRBIME</b>		<b>1,375,656.19</b>	<b>1,204,027.48</b>
Me kodin ekonomik 13780 Karburante për vetura sipas memorandumit të mirëkuptimit i kemi paguar “Unitetit” 7 000 litra naftë për eliminimin e deponive të mbeturinave si dhe 685 lira naftë “Ibër Lepencit” për hapjen e kanaleve kulluese			

<b>14</b>		<b>Janar Dhjetor 2015</b>	<b>Janar Dhjetor 2014</b>
13210	Rryma	164,380.31	127,272.23
13220	Uji	28,555.27	21,253.75
13230	Mbeturinat	32,878.37	31,692.73
13250	Shpenzimet telefonike	11,606.72	13,925.28
<b>14</b>	<b>TOTALI I SHPENZIMEVE KOMUNALE</b>	<b>237,420.67</b>	<b>194,143.99</b>

#### Shpenzimet komunale

Totali i shpenzimeve komunale për Komunën e Vushtrrisë është 237,420.67 ose 18% më shumë se viti 2014, por duhet të theksohet se për kyqjen e Fabrikes së Ujit Komuna nga shpenzimet komunale kategoria e Rrymës ka paguar shumën 20.156.33 €

#### Subvencione dhe transfere

<b>20</b>		<b>janar dhjetor 2015</b>	<b>janar dhjetor 2014</b>
21110	Subvencionet per Etnitete Publike	27,990.00	22,500.00
21200	Subvencionet per Etnitete Jopublike	150,871.95	220,480.00
<b>20</b>	<b>TOTALI I SUBVENCIONEVE</b>	<b>178,861.95</b>	<b>242,980.00</b>



## Të hyrat vetanake sipas drejtorive

	<u>Planifikimi i THV</u>	<u>Realizimi 2015</u>	<u>2014</u>	<u>Përqindja e realizimit</u>
Administrata personeli	87.500.04	71.708.00	73.178	82%
Inspeksioni	5.826.96	5.323.50	12.827.39	91%
Buxhet dhe financa	641.548.08	535.589.76	617.657.46	83%
Arsimi	72.999.96	59.544.25	77.116.60	82%
Gjeodezi dhe kadaster	80.000.00	79.473.90	106.083.00	99%
Kulturë Rini dhe Sport	7.500.00	4.199.00	4.809.50	56%
Shërbime publike	115.000.00	107.498.98	98.902.05	91%
Bujqësia	25.000.00	18.823.00	20.228.25	75%
Shëndetësi	50.000.00	48.782.00	45.211.50	98%
Urbanizmi	376.000.00	369.850.63	179.500.00	98%
Gjjobat e trafikut	208.000.00	71.335.51	134.181.00	34%
TOTALI	1.675.375.00	1.400.925.33	1.369.695.70	84%

Planifikimi .....1,675,327.08€

Realizimi .....1,400,925.33€

Shprehur në % është .....84%

Krahasuar me vitin 2014,realizimi në vitin 2015,duke duke mos përfshirë donacionet është për 2.28%,më i madh se në vitin 2014.

Të hyrat e bartura nga viti 2014 janë 493,421.27 €, të hyrat e realizuara gjatë vitit janë 1,400,925.33 €, shuma e të hyrave vetanake plus të hyrat e bartura janë 1,894,346.60 €. Nga kjo shumë janë shpenzuar 1,435,246.51 €, ndërkaq për bartje në vitin 2015 kanë mbetur 459,100.09€

## **Ekonomi bujqësi pylltari**

### Sektori për biznes :

Qendra komunale e bizneseve si sektor i Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim Rural ( DEBZHR),- si objektiv të punës ka paraparë gjithherë krijimin e kushteve më të mira bizneseve të cilat ushtrojnë veprimtari afariste në territorin e komunës sonë në radhë të parë duke i pajisur me certifikatat e biznesit me kohë. Gjatë vitit 2015 bizneset regjistrohen pa pagese vetëm me letërnjoftim dhe brenda afatit të shkurtër kohor. Një (1) dite për biznese individuale. Synimi për përmirësimin e klimës për të bërë biznes në komunë është realizuar pothuajse në tërësi, sepse nuk ekzistojnë kurrfarë barrierë administrative dhe të taksave për të filluar biznesin në komunën tonë, ndërmarrësit që të jenë të suksesshëm në treg.

Gjate muajit korrik të vitit 2015 në bazë të Udhëzimit Administrativ (MTI) nr.03/2015 për Përcaktimin e Taksave dhe Shërbimet e Ofruara nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve, janë ofruar ndryshimet e taksave për Shoqëritë aksionare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, Shoqëritë e huaja tregëtare dhe kooperativat bujqësore si vijon:

- çdo ndryshim në biznes ka qene 20 € tani është 10 €
- kërkesa për shuarje të biznesit ka qene 10 € tani është 00 €, ndërsa për biznese individuale,
- çdo ndryshim në biznes ka qenë 5 € tani është 00 €
- kërkesa për shuarje të biznesit ka qenë 5 € tani është 00 €

Deri më 31.12.2015 në QKB në Vushtrri janë regjistruara këto biznese:

<u>Nr.</u>	<u>Përshkrimi i aktivitetit</u>	<u>Nr.i llojit</u>	<u>Vërejtje</u>
1.	Biznese të reja individuale të regjistruara .	215	
2.	Biznese të reja ( të regjistruara )	21	
3.	Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara		
3.	Biznese të shuara	100	
4.	Ndërrime të logove të certifikatave	84	
5.	Ndryshime në bizneset ekzistuese	104	
	<b>Gjithsej</b>	<b>524</b>	

Gjatë vitit 2015 në komunën tonë kemi pasur gjithsej 236 biznese të reja të regjistruara, prej të cilave 21 kanë qenë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, ndërsa pjesa tjetër biznese individuale. Në vitin e kaluar (2014) kemi pasur 205 biznese të reja të regjistruara, prej tyre 10 biznese të reja ( të regjistruara ) Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Përveç shërbimeve të lartshënuara Qendra Komunale e Bizneseve ka kryer edhe lëndë të tjera si:

- vazhdimin e lejeve për transportin autotaxi
- dhënia e certifikatave për personat të cilët nuk kanë biznes të regjistruar
- certifikata për nevoja personale
- certifikata për personat të cilët kanë ushtruar veprimtari biznesi et

Në vazhdim do të japim pasqyrën tabelare të bizneseve të regjistruara gjatë periudhës 01.01 – 31.12.2015

Kodi	VEPRIMTARIT EKONOMIK	Bizneset prej 01.01-31.12.2015	%
1	Bujqësia, Gjuetia dhe pylltaria	24	10.16
2	Industria përpunuese	27	11.44
3	Furnizimi me energji elektrike dhe ujë	1	0.42
4	Ndërtimtaria	17	7.2
5	Tregtia me shumicë dhe pakice riparimi i automjeteve dhe aparateve tjera të amvisëri	71	30.1
6	Hotelet dhe Restorantet	32	13.56
7	Transporti, depot dhe telekomunikacion	22	9.33
8	Aktivitetet Financiare	2	0.84
9	Pasurit e patundshme: dhënia me qira dhe aktivitetet e biznesit	23	9.75
10	Administrimi dhe Mbrojtja publike Mbrojtja e obligueshme sociale	1	0.42
11	Arsimi	3	1.28

12	Aktivitet tjera shoqërore dhe personale	13	5.50
	<b>Totali</b>	236	100

Numri i të punësuarve në biznese:

Në bazë të të dhënave të siguruar nga ATK – zyra regjionale në Mitrovicë ekziston ky numër i të punësuarve :

-Punëtor të paraqitur në biznes 3646  
 -Të vetëpunësuar në bizneset individuale 2049

**Gjithsej 5695**

Duke u bazuar në të dhënat e siguruar nga ATK – zyra regjionale në Mitrovicë vetëm për vitin 2015 i kemi 892 të punësuar në sektorin privat. Ky numër i të punësuarve në biznese private është variabil dhe mund të ndryshoj çdo herë, bie fjala gjatë sezonës së verës shumë biznese të cilat merren me veprimtari ekonomike të prodhimit, përpunimit etj. mund të rrisin numrin e punëtorëve të tyre, për shkak të rritjes së volumit të punës ndërsa gjatë sezonës së dimrit mund të bie. Në rastin tjetër bizneset e mëdha në një periudhë të caktuar mund të hapin një njësi tregtare në një qytet tjetër dhe përnjëherë mund të rrisin numrin e të punësuarve 70 – 80 punëtor në atë qytet. Rasti i kundër mund të ndodh kur një biznes i madh i një qyteti tjetër hap një njësi tregtare në komunën tonë.

Numri i punëkërkuësve

Në bazë të të dhënave të marra nga Zyra komunale e punësimit në Vushtrri kemi këto të dhëna:

Prej 01.01.2000 deri 15.12.2015

<b>Grup mosha</b>	<b>Totali</b>	<b>Femër</b>	<b>mashkull</b>
15 -24	568	278	290
23-39	2028	836	1192
40-54	1155	432	723
-55+	152	43	109
<b>Totali</b>	3903	1589	2314

**Punëkërkuësit e regjistruar – niveli i edukimit prej 01.01.2000 deri 15.12.2015**

<b>Niveli i edukimit</b>	<b>Totali</b>	<b>Femra</b>	<b>meshkuj</b>
I pa kualifikuar	1734	846	888

Shkolle fillore	810	357	453
Shkolle e mesme	1180	283	897
Shkollë e Larte	6	0	6
Universitet	161	100	61
Master	12	3	9
<b>Total</b>	<b>3903</b>	<b>1589</b>	<b>2314</b>

Në bazë të dhënave nga ZKP – Vushtrri vetëm në vitin 2015 i kemi 986 punëkërkes në komunën tonë.

Objektivat e Qendrës Komunale të Bizneseve - janë:

- ofrimi i shërbimeve të avancuara për biznese
- zvogëlimi i numrit të bizneseve pasive
- bashkëpunimi më i ngushtë me biznese e sidomos me ato prodhuese të cilat mund të gjenerojnë vende të reja te punës.
- vizitat me të shpeshta nëpër biznese me qëllim që të njihen me mundësit e zgjerimit të bizneseve të tyre, etj.
- Përkrahja e bizneseve të vogla individuale duke krijuar mundësin e vetëpunësimit
- Përkrahja e bizneseve bujqësore etj.

### Bujqësia

Gjatë vitit janar -dhjetor 2015 në sektorin e bujqësisë janë zhvilluar një numër i konsiderueshëm i aktiviteteve, aktivitete si vijon:

Në masën e subvencionimit të sipërfaqeve të mbjella me **grurë, misër, luledielli** kanë përfituar **952** fermer.

Në masën e subvencionimit të sipërfaqeve të mbjella me **patate e perime tjera** kanë përfituar 224 fermer ;

Në masën e subvencionimit të **deleve dhe dhive** kanë aplikuar gjithsej **31** fermer;

Në masën e subvencionimit të **gjedheve** qumështore kanë përfituar gjithsej **379** fermer;

Në masën e subvencionimit të shoqërive të **bletëve** kanë përfituar gjithsej **74** fermer;

Në masën e subvencionimit të derrave kanë përfituar 4 fermer të nacionalitetit serb:

Në masën e subvencionimit direkt të **qumështit** kanë përfituar gjithsej **30** fermer

Është implementuar një projekt i furnizimit me **serra** në sipërfaqe prej gjysmë ari (10) si dhe me nga një ari (15) fermerë, gjithsejtë (**25** përfitues). **Vlera:48.400 €**. Një projekt të përkrahur nga „TIKA,, - furnizim me **bidona për qumësht** për **150** fermerë, si dhe për 10 përfitues ekomilka dhepistoleta alkoolike në vlerë prej:**30,000.00€**.

Me Organizatën turke ”TIKA” është bërë implementimi i projektit për furnizim me **10** makina për nxjerrjen e qepëve: vlera **32,000.00 €** .

Në masën aplikimi për **Grante** fermerët kanë aplikuar në Mitrovicë në zyrën Regjionale të MBPZHR.

Me IADK kemi vazhduar me aktivitete të llojit të ndryshëm dhe ate kryesisht në perimekulturë dhe blegtori ku fermerëve ju është mundësua ndjekja e trajnimeve në degët kryesore të bujqësisë (kemi të nënshkruar një memorandum mirëkuptimi).

**Shërbimet këshillimore – vlera totale e projektit ; 13056( IADK;7180.80 € [55%]  
Komuna; 5875.20 € [45%].**

**Bashkëfinancimi i projekteve të IADK Dhe Komunës Vushtrri ;** kultivimi i rigonit të bardhë, kultivimi i mjedrave, përgatitja e kompostit dhe substratit, kultivimi i specit ne fushe të hapur, investimet në kuzhinën e shkollës (projekti I EU), Investimet në kuzhinën e shkollës (projekti i BfW), prodhimentaria organike e mjaltit, vlera totale e projektit: 38,468.82, IADK:26,904.45€ ( 70%), KOMUNA:10,966.07€ (29%) FERMERET: 598.30€(1%)

**Projekti i deleve** Furnizimi i fermerëve me kope delesh për fermer,21 përfitues me nga 20 dele, vlera: 45,000€ komuna 10,000€ përfituesit

**Projekti i gjedheve qumështore** Furnizimi me lopë qumështore për fermer 30 përfitues me nga dy gjedhe. Vlera: 60,000€ komuna, 40,000€ përfituesit

**Projekti i ngritjes së pemishtes** Furnizimi me fidane të mollës për fermer, 14 përfitues me 0.50 ha  
60,000,00 komuna, 7,882.00 fermerët

**Projekti i dhive qumështore,** Furnizimi me dhi qumështore për fermer, 36 përfitues me një tufe prej 10 krerë dhishë, Vlera: 30,000.00€ komuna, 12,600.00€ përfituesit.

nr	Lloji i investimit	shuma	komuna	përfituesit	Nr. përfituesve
1	Projekti me serra	48,400.00€	40,000.00€	8,400.00€	25
2	Projekti i deleve	55,000.00€	45,000.00€	10,000.00€	21
3	Lopëve qumështore	100,920.00€	60,000.00€	49,020.00€	30
4	Ngritja e pemishteve	67,882.00€	60,000.00€	7,882.00€	14
5	Projekti i dhive	42,600.00€	30,000.00€	12,600.00€	35
	Shuma totale	<b>314,402.00€</b>	<b>235,000.00€</b>	<b>87,902.00€</b>	

Investimet në bashkëfinansim me donatorët në sektorin e bujqësisë

nr	Lloji I investimit	shuma	komuna	donatori	Nr. përfituesve
1	Projekti nga tika a) bidona për qumësht b) ekomilka pistoleta alkoolike c) makina për nxjerrjen e qepëve	30,000.00€  32,000.00€	/		a)150  b)10  c)10
2	Projektet me IADK	38,462.00€	10,966.00€	26,904.00€	
3	Projekti me BE	512,839.00€	51,238.00€	461,555.00€	
4	Shuma totale	<b>583,301.00€</b>	<b>62,204.00€</b>	<b>488,459.00€</b>	

**PUNËT EKRYERA NË PYJE PUBLIKE - SHETRORE**

Nr	Përmbajtja	Viti 25015			
1.	Të hyrat, pyje publike nga shitja	336.32€			
2.	Raporti i fl. paraqitjeve, shuma në €	207Flp=454.905m <sup>3</sup> =48827.03€			
3.	Specifikacioni i konfiskimit	23konf=93.40m <sup>3</sup>			
4.	Gjendja në depo	26.40m <sup>3</sup>			
5.	Plani i pyllëzimeve				
6.	Raporti i zjarreve	273.50.ha			
7.	Raporti mbi regjistrimin e tereneve	497.86m <sup>3</sup> =56710.68€			
8.	Kontrolla tereneve	90			
9.	Vjedhje në depo				
10.	Shpërndarje, familjeve skamnore	67.00m <sup>3</sup>			

1.	Kërkesa për prerje	83copë	
2.	Të shqyrtuara	58=1458.96m3	
3.	Të pa shqyrtuara	25	
4.	Specifikacioni i fl. përcjelljeve në pyje private	193 copë=388.00m3	
5.	Të hyrat në pyje private	1986.50€	
6.	Fletëpagesa në pyje private	47 copë=1986.50€	

## **Prokurimi Publik**

Parimet bazë mbi të cilat mbështetet aktiviteti i prokurimit janë parimi i ekonomicitetit ( vlerës për paranë ), efikasitetit, transparencës etj. Duke zbatuar këto parime, është synuar që, në të gjitha aktivitetet e prokurimit të realizuara në drejtorinë komunale për prokurim, të sigurohet që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën sa më ekonomike, sa më efikase, më transparente dhe më të drejtë, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, poashtu që fondet publike dhe burimet publike që janë ofruar ose që janë vënë në dispozicion, sipas një kontrate publike, të mundë të përdoren nga kontrata e tillë dhe vetëm për qëllimet e të njejtës.

Në periudhën raportuese, Drejtoria, konform dispozitave ligjore që rregullojnë lëmin e prokurimit publik, ka iniciuar dhe realizuar 239 prokurime për t'i realizuar dhe përmbushur kërkesat për gjitha shtyllat e buxhetit të Autoritetit Kontraktues, si vijon : Administratë Komunale, Arsimit duke përfshirë këtu dhe gjitha shkollat e mesme dhe fillore si dhe institucionin parashkollorë, Shëndetësi dhe Qendër për Punë Sociale, Njësia e Zjarrfikësve, Zyra lokale e komuniteteve, dhe Zyra për kthim të komuniteteve.

Në vazhdim janë paraqitur të dhënat lidhur me Planifikimin dhe realizimin e prokurimeve për vitin 2015.

### II.1) KONTRATAT PËR FURNIZIM

<b>Klasifikimi i Produktit (2 shifrat e para nga FPP)</b>		<b>Përshkrimi i Kontratës</b>	<b>Njësia</b>	<b>Projekti është realizuar PO / JO</b>
21	1	<b>Furnizim me material zyrtar</b>	Kon.	Kontratë kornizë me afat



15	2	Furnizim me artikuj ushqimor	Kon.	Kontratë kornizë me afat
11	3	Furnizimi me naft dhe derivate të naftës	Kon.	Po
22	4	Furnizim me materiale të shtypura për zyre	Kon	Po
36	5	Furnizimi me orendi për zyre	Kon.	Po
31	6	Furnizimi me pajisje tjera	Kon.	Po
18	7	Furnizimi me veshmbathje	Kon.	Po
24	8	Furnizimi me material higjenik	Kon.	Kontratë kornizë me afat
30	9	Furnizimi me teknologji informative dhe pajisje tjera elektronike	Kon.	Po
2	10	Furnizimi me dru për ngrohje	M <sup>3</sup>	Po
10	11	Furnizimi me thëngjill për ngrohje	Ton	Kontratë kornizë me afat
30	12	Furnizimi me aparate fotokopjuese	Kon.	PO
28	13	Furnizimi me automjete (autoambulancë)	Kon.	Po
33	14	Furnizimi me gypa për kanalizim	Kon.	Po
34	15	Furnizimi me Pajisje mjekësore laboratorike - Stomatologjike	Kon.	Po
28	16	Furnizimi me pajisje laboratorike për shkollat e mesme	Kon.	Po
22	17	Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve	Kon.	Kontratë kornizë me afat
29	18	Furnizimi dhe vendosja e kamerave në qytet	Kon.	Po
21	19	Furnizimi me medikamente për QKMF	Kon.	Po
21	20	Furnizimi me medikamente për QKMF	Kon.	

## II. 2) Kontratat për Shërbime

Klasifikimi i Shërbimit (2 shifrat e para nga FPP)		Përshkrimi i Kontratës	Projekti është realizuar PO / JO
50	1.	Servisimi i teknologjisë informative	po

78	2.	Botimet e reklamave dhe konkurseve	po
64	3.	Shërbimet e internetit	po
55	4.	Shërbime hotelierer	po
50	5.	Riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve	po
93	6.	Shërbime tjera kontraktuese të kohëpaskohëshme	po
93	7.	Mirëmbajtja e objekteve	po
92	8.	Shërbime të ndryshme	po
63	9.	Shërbimet e udhëtimit jashtë vendit	po
80	10.	Shërbimet Arsimore dhe trajnuese	po
85	11.	Shërbimet e ndryshme shëndetësore	po
93	12.	Regjistrimi dhe kontrolla teknike e automjeteve	po
93	13.	Mirëmbajtja e infrastrukturës rrugore	po
74	14.	Hartimi i hartës zonale	po
78	15.	Hartimi i projekteve	po
22	16.	Shtypja e materialeve për zyre të QKMF-re	po
74	17.	Shërbimet intelektuale dhe këshillëdhënëse	po
60	18.	Shërbimet e udhëtimit brenda vendit	po
50	19.	Mirëmbajtje e mobileve dhe pajisjeve	po

### II. 3) KONTRATAT PËR PUNË

<b>Klasifikimi i Punëve (2 shifrat e para nga FPP)</b>		<b>Përshkrimi i kontratës / Karakteristikat thelbësore të secilës kontratë për punë</b>	<b>Projekti është realizuar PO / JO</b>
45	1.	Ndërtimi i rrugës "Wesly Clark"	Punët kanë filluar me vonesë. Arsye është se ka ekzistuar një marrëveshje në mes të Komunës dhe Qeverisë së Luksemburgut për bashkëfinancim të projektit për Instalimin e Ujësjetës, projekt i cili duhet ti paraprijë Ndërtimit të rrugës "Wesly

			Clark" Duke qenë se instalimi i ujës-jellësit ka përfunduar edhe punët në ndërtimin e rrugës kanë përfunduar në masën 95%. Pjesa e papërfunduar mbetet të përfundohet me të krijuar kushtet klimatike për punë në vitin 2016.
45	2.	Asfaltimi i rrugës "Kongresi i Manastirit", me infrastrukturë	po
45	3.	Asfaltimi i rrugës "Lumni Surdulli" - Shelgjet e Hasan Musës	po
45	4.	Asfaltimi i rrugës "Gjon Buzuku" segmenti I	po
45	5.	Vazhdimi i asfaltimit të rrugës "Hamdi Gashi"	po
45	6.	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Druar Lagjet: Selani, Bojku, Bajgora dhe Nemozhët <b>(projekt dy vjeçar)</b>	Po, aq sa ka pasur mjete financiare të planifikuara në vitin fiskal 2015.
45	7.	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Reznik Lagjet: Ujkani, Mustafa, Haliti, Makiqi te xhamija	po
45	8.	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Mihaliq lagjet: Syla-Ahmeti dhe Zhushi	po
45	9.	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Shallc <b>(projekt dy vjeçar)</b>	Po, aq sa ka pasur mjete financiare të planifikuara në vitin fiskal 2015.
45	10	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Bivolak	po
45	11	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Bequk, Lagja Murati	po
45	12	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Gllavotin	po
45	13	Asfaltimi i rrugëve Zhilivodë-Stroc Lagja Isufi dhe Aliu	po
45	14	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Novolan <b>(projekt dy vjeçar)</b>	Po, aq sa ka pasur mjete financiare të planifikuara në vitin fiskal 2015.
45	15	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Pantinë Lagjet: Morina, Hyseni - Zejnullahu <b>(projekt dy vjeçar)</b> Në realizim e sipër	Po, aq sa ka pasur mjete financiare të planifikuara në vitin fiskal 2015.
45	16	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Oshlan, Lagjet: Ferizi- Hyseni - Moni	po
45	17	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Akrashticë,	po

		Lagja Mehana	
45	18	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Shtitaricë, Lagja Mehulli - Rruka	po
45	19	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Galicë	po
45	20	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatrat Dubovc - Beqiq me infrastruktur	po
45	21	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Dobërlukë, lagja Rrahimovit - Ajvazovit	po
45	22	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Pasomë afër shkollës	po
45	23	Asfaltimi i rrugës në fshatin Smrekonicë, xhamia te varrezat	po
45	24	Asfaltimi i rrugës në fshatrat Skromë-Bozhlan-Vesekovc- Kurillovë ( <b>projekt tre vjeçar</b> )	Po, aq sa ka pasur mjete financiare të planifikuara në vitin fiskal 2015.
45	25	Asfaltimi i rrugëve në Samadrexhë - Zagori	po
45	26	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Maxhunaj	po
45	27	Asfaltimi i rrugëve në Ropicë - Maxhunaj	po
45	28	Asfaltimi i rrugëve në Dumnicë e Poshtme - Stanoc- Shkolla "Jusuf Gërvalla "	po
45	29	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Dumnicë Lagja Balaj-Abazi	po
45	30	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Stanoc - Lummadh ( <b>projekt dy vjeçar</b> )	Po, aq sa ka pasur mjete financiare të planifikuara në vitin fiskal 2015.
45	31	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Prelluzhë	Projekti nuk është realizuar për shkak të mosplotësimit të buxhetit nga të hyrat vetjake
45	32	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Pestovë	po
45	33	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Sfaracak Zjarrëfikësat - Lagjet Muliqi - Kutllovci - Xhafa ( <b>projekt dy vjeçar</b> )	Po, aq sa ka pasur mjete financiare të planifikuara në vitin fiskal 2015.
45	34	Asfaltimi i rrugës në fshatin Gojbulë segmenti I	po
45	35	Asfaltimi i rrugëve në studime trafo te shkolla-Rashica - Studime-Ceceli ( <b>projekt dy vjeçar</b> )	Duke qenë se projekti është dy vjeçarë, punimet janë në ekzekutim e sipër edhe në vitin 2015po
45	36	Punimi i numrave të shtëpive	Po, aq sa ka pasur mjete financiare të planifikuara në

			vitin fiskal 2015.
45	37	Ndërtimi i parkingjeve	po
45	38	Ndërtimi i rrugëve me kubëza betoni	po
45	39	Ndërtimi i trotuareve	po
45	40	Riasfaltimi dhe mirëmbajtja e rrugëve	po
45	41	Ndërtimi i urave në fshatrat Samadrexhë dhe Smrekovnicë	po
45	42	Vendosja e shportave në qytet	Po
45	43	Ndriqimi Publik	po
45	44	Rregullimi i varrezave dhe Lapidareve	Po
45	45	Ndërtimi i kanalizimeve	Po
45	46	Bashkëfinancim me donatorë	po
45	47	Rrugët e rendit të IV -të	po
45	48	Gjelbërimi i Hapësirave publike	po
45	49	Ndërtimi i shkollave fillore në fshatrat Druar, Pantinë dhe Maxhunaj ( <b>projekt tre vjeçar</b> )	Po, aq sa ka pasur mjete financiare të planifikuara në vitin fiskal 2015.
45	50	Ndërtimi i aneksit në shkollën fillore në fshatin Stanoc lagja Cakaj	Po
45	51	Renovimi i shkollës "Liria" në fshatin Stroc	Po
45	52	Renovimi i shkollës Reznik, paralelja e ndarë në Shalle	Po
45	53	Ndërtimi i objektit përcjellës në Gjimnazin "Eqrem Çabej"	po
<b>45</b>	54	Renovimi i shkollës "Azem Bejta" në fshatin Duboc	po
<b>45</b>	55	Renovimi i shkollës "Enver Hadri" në fshatin Smrekonicë	po
<b>45</b>	56	Renovimi i shkollës "Emin Duraku" në fshatin Novolan	po
<b>45</b>	57	Ndërtimi i objektit përcjellës në shkollën fillore "Bajram Curri" Dumnicë e Mesme	po
<b>45</b>	58	Renovimi i shkollës "Rilindja" në fshatin Vilanc	po
<b>45</b>	59	Renovimi i shkollës "Migjeni" në fshatin Stanoc i Epërm	po

45	60	Renovimi i shkollës "Bahri Kuqi" në fshatin Shtrucherë	po
45	61	Rregullimi i fushës sportive në SHMU II	po
45	62	Ndërtimi i rrethojës në shkollën fillore "Rilindja" në fshatin Pestovë	po
45	63	Ndërtimi i rrethojës në shkollën fillore në fshatin Zhilivodë	po
45	64	Ndërtimi i rrethojës së fushës sportive në SHMU I	po
45	65	Ndërtimi i rrethojës në shkollën fillore "Bahri Kuqi" në fshatin Shtrucherë	po
45	66	Ndërtimi i rrethojës në shkollën fillore "Migjeni" në fshatin Stanoc i Epërm	po
45	67	Ndërtimi i rrethojës në shkollën fillore "Enver Hadri" në fshatin Smrekonicë	po
45	68	Ndërtimi i fushës sportive në shkollën fillore "Jusuf Gërvalla" në Dumnice e Poshme	po
45	69	Ndërtimi i fushës sportive në shkollën fillore "Mustafë Shyti" në fshatin Oshlan	Është kontraktuar puna, janë kryer punë të konsiderueshme, por projekti nuk ka mundë të përfundohet për shkak të jo stabilitetit të terrenit. Mbetet të përfundohet në vitin 2016
45	70	Renovimi i objekteve shëndetësore	po
45	71	Ndërtimi i QMF-së ( <b>projekt dy vjeçar</b> )	Po, aq sa ka pasur mjete financiare të planifikuara në vitin fiskal 2015.
45	72	Renovimi i palestrës sportive	po
45	73	Bashkëfinancim me donatorë (CHwB)	po
45	74	Funksionalizimi i kullës së Azem e Shotë Galicës	Jo, për shkak të paraqitjes së kontesteve pronësore
45	75	Renovimi i Qendrës së Kulturës	Jo, për shkak të kërkesës së organeve për definimin të gjendjes teknike dhe strukturore të objektit
45	76	Ndërtimi i rrethojës për oborrin e Kalasë	po
45	77	Rregullimi i Lumenjve dhe Bademeve	Jo, Projekti nuk është realizuar për shkak të mosplotësimit të buxhetit nga të hyrat vetjake
45	78	Blegtori sektori i Gjedheve	po

45	79	Blegtori sektori i Deleve	po
45	80	Blegtori sektori i Dhive	po
45	81	Perim Kulturë	po
45	82	Pemëtari	po
45	83	Bletari	Jo, për shkak se edhe përkundër kontraktimit, paraqitja e sëmundjes tek bletët dhe reagimit të AVUK-ut, kontrata është ndërprerë, ndërsa bletët janë asgjasuar dhe varrosur me vendim dhe nën monitorimin e AVUK-ut.
45	84	Fondi për bashkëfinancim me donatorë	po

Krahasimi i pasqyrave të prokurimeve të evidentuara dhe të realizuara nga Autoriteti kontraktues në vitin 2015 na dërgon në konstatimin se, edhe përkundër grupimit të projekteve të cilat për nga natyra e realizimit kanë qenë të njëjta, megjithatë kemi pasur një rritje të konsiderueshme të projekteve të cilat janë proceduar, kontraktuar dhe realizuar në këtë vit. Duke zbatuar një procedurë, me qëllim të ekonomizimit dhe efikasitetit, duke pasur parasysh gjithnjë transparencën në raport me Operatorët Ekonomik të interesuar, është arritur që procedimi i projekteve të planifikuara të realizohet në kohë dhe në mënyrë të suksesshme.

Në vazhdim, është paraqitur një pasqyrë tabelare - krahasuese të prokurimeve të evidentuara gjegjësisht të prokuruar, për gjitha vlerat dhe procedurat, në vitin 2013 dhe 2014 dhe 2015

**Tab.nr.1**

<b>Pasqyra tabelare e prokurimeve – kontratave të evidentuara dhe të realizuara gjatë dy viteve të fundit</b>				
<b>Viti</b>	<b>2013</b>	<b>2014</b>	<b>2015</b>	<b>Vërejtje</b>
Numri i prokurimeve (gjitha procedurat )	231	212	239	
Vlera e parashikuar	5.092.559,79€	3.753.068,93€	7.629.967,94€	
Vlera e kontraktuar	4.469.997,61€	3.051.236,08€	6.227.524,89€	
Diferenca mes mjeteve të planifikuara dhe të kontraktuara	622.562,18€	701.832,85€	1.402.443,05€	

Nga gjithë aktivitetet e prokurimit të procesuara në këtë vit, me theks të veçantë të prokurimet për punë, në asnjë aktivitet të prokurimit nuk ka pasur punë shtesë. Edhe ky fakt tregon se si nga ana e drejtorisë ashtu dhe nga ana e Operatorëve Ekonomik të përzgjedhur ka pasur një performancë të kënaqshme sa i takon realizimit, si në kohë ashtu dhe në cilësi, të ekzekutimit gjegjësisht realizimit të projekteve.

Duhet theksuar po ashtu se për vonesa të paarsyeshme në përfundimin e projekteve sipas planit dinamik të kontraktuar drejtoria ka qenë e detyruar që, konform dispozitave të LPP-së dhe Kushteve të përcaktuara në Kontratën e Punës, Furnizime apo Shërbime, të aplikoi penale ndaj disa Operatorëve Ekonomik ( 4 Operatorve Ekonomik ). Vonesa nuk kanë qenë të asaj natyre sa të rrezikojnë realizimin e projekteve, në rendë të parë në Krahasimi i pasqyrave të prokurimeve të evidentuara dhe të realizuara nga Autoriteti kontraktues në vitin 2015 na dërgon në konstatimin se, edhe përkundër grupimit të projekteve të cilat për nga natyra e realizimit kanë qenë të njëjta, megjithatë kemi pasur një rritje të konsiderueshme të projekteve të cilat janë proceduar, kontraktuar dhe realizuar në këtë vit. Duke zbatuar një procedurë, me qëllim të ekonomizimit dhe efikasitetit, duke pasur parasysh gjithnjë transparencën në raport me Operatorët Ekonomik të interesuar, është arritur që procedimi i projekteve të planifikuara të realizohet në kohë dhe në mënyrë të suksesshme.

Në vazhdim, është paraqitur një pasqyrë tabelare - krahasuese të prokurimeve të evidentuara gjegjësisht të prokuruar, për gjitha vlerat dhe procedurat, në vitin 2013 dhe 2014 dhe 2015

**Tab.nr.1**

<b>Pasqyra tabelare e prokurimeve – kontratave të evidentuara dhe të realizuara gjatë dy viteve të fundit</b>				
<b>Viti</b>	<b>2013</b>	<b>2014</b>	<b>2015</b>	<b>Vërejtje</b>
Numri i prokurimeve (gjitha procedurat )	231	212	239	
Vlera e parashikuar	5.092.559,79€	3.753.068,93€	7.629.967,94€	
Vlera e kontraktuar	4.469.997,61€	3.051.236,08€	6.227.524,89€	
Diferenca mes mjeteve të planifikuara dhe të kontraktuara	622.562,18€	701.832,85€	1.402.443,05€	



Nga gjithë aktivitetet e prokurimit të procesuara në këtë vit, me theks të veçantë të prokurimet për punë, në asnjë aktivitet të prokurimit nuk ka pasur punë shtesë. Edhe ky fakt tregon se si nga ana e drejtorisë ashtu dhe nga ana e Operatorëve Ekonomik të përzgjedhur ka pasur një performancë të kënaqshme sa i takon realizimit, si në kohë ashtu dhe në cilësi, të ekzekutimit gjegjësisht realizimit të projekteve.

Duhet theksuar po ashtu se për vonesa të paarsyeshme në përfundimin e projekteve sipas planit dinamik të kontraktuar drejtoria ka qenë e detyruar që, konform dispozitave të LPP-së dhe Kushteve të përcaktuara në Kontratën e Punës, Furnizime apo Shërbime, të aplikoi penale ndaj disa Operatorëve Ekonomik ( 4 Operatorve Ekonomik ). Vonesa nuk kanë qenë të asaj natyre sa të rrezikojnë realizimin e projekteve, në rendë të parë në aspektin cilësor dhe sasiorë. Vlera financiare e aplikimit të penaleve kap shumën prej 2,347.33€. Po ashtu gjatë viti 2015 kemi pasur 3 ( tri ) raste kur kontrata është dashur të ndërpritet dhe të konfiskohet Garancioni i Ekzekutimit të Kontratës, për shkak të pamundësisë prej Operatorit Ekonomik – Kontraktuesit që të përmbushë me sukses kontratën e lidhur. Vlera e përgjithshme e mjeteve financiare të konfiskuara në emër të Garancionit të Ekzekutimit të Kontratës është në shumë prej 12,722.56€

Konsiderojmë me interes të theksojmë se nga gjitha prokurimet e realizuara në këtë vit, që po i referohet edhe ky Raport pune, kemi të evidentuar dy ankesa të Op. Ek drejtuar në OSHP ( Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik ) dhe të dy këto ankesa janë refuzuar si të pabazuara nga OSHP-ja dhe është vërtetuar vendimi i Autoritetit Kontraktues – Drejtorisë Komunale për Prokurim Publik.

## **Administrata**

Është punuar në avancimin e administratës dhe duke ofruar shërbime sa më të mira për qytetarët në interesin e qytetarëve.

### Sektori i Gjendjes Civile

Trendi i ngritjes së efikasitetit dhe i ofrimit të shërbimeve me te mira dhe me efikase është ne ngritje ne këtë shërbim duke ju falënderuar angazhimit dhe punës që bëjnë zyrtaret e gjendjes civile dhe po ashtu në këtë trend pozitiv ka ndikuar edhe kthimi i librave të gjendjes civile dhe atyre fetare, ngase, kanë ndikuar në lehtësimin dhe shpejtimin e procedurave për tu pajisur me certifikata dhe dokumente të gjendjes civile.

### Numri i dokumenteve të lëshuara

<b>Nr.</b>	<b>Përshkrimi</b>	<b>Lëshuara</b>
1.	Ekstrakt i lindjes	38561
2.	Certifikata të lindjes	10985
3.	Certifikata të martesës	7015
4.	Certifikata të vdekjes	1827
5.	Certifikata të Statusit martesor	2432

6.	Certifikata të shtetësisë	692
7.	Certifikata familjare	5682
8.	Certifikata të vendbanimit	1787
9.	Vërtetim nga arkivi	643
10.	Akt i vdekjes	360
11.	Deklarata e Atësisë dhe Amësisë	145
12.	Lajmërim dhe Ç'lajmërim i Vendbanimit	860
<b>Gjithsejtë</b>		<b>70989</b>

Prej 70989 certifikata dhe dokumenteve të lëshuara, 14500 dokumente janë lëshuara pa pagesë për raste të ndryshme (raste sociale, veteran, familje të dëshmorëve, invalid, etj, e kategori të ndryshme të parapara me rregulloren për tarifa të Komunës së Vushtrrisë.)

#### Regjistrime të bëra në Regjistrat e Gjendjes civile

1	Regjistrime të lindjes	438
2	Martesa	748
3	Regjistrime të vdekjes	300
4	Regjistrime të Shtetësisë	80
5	Regjistrime të lindjes jashtë shtetit	398
6	Regjistrime të martesës jashtë shtetit	92
7	Regjistrime të vdekjes jashtë shtetit	50
<b>Gjithsejtë regjistrime të bëra</b>		<b>2106</b>

Në këtë periudhë janë verifikuar 15899 qytetarë në sistemin e ri të gjendjes civile, ndërsa që kemi pasur kërkesa edhe për vendosjen e fotografive në certifikatë të lindjes dhe kemi pajisur rreth 60 palë me vendosjen e fotografisë.

#### Qendra për shërbim të qytetarëve (QSHQ):

Aktiviteti i saj ka të bëjë me ofrimin e shërbimeve për qytetarët, bizneset dhe subjektet tjera të cilat i drejtohen organeve të Komunës me kërkesë për shërbime të caktuara.

Shërbimet të cilat i ka kryer QSHQ, janë: Pranimi elektronik i kërkesave, Skanimi i kërkesave, Protokoll elektronik, Unifikimi i protokollit, Procesimi elektronik i lëndëve, Kthimi elektronik i përgjigjeve, Tavolina informative, etj.

#### Numri i lëndëve sipas drejtorive dhe statusit të zgjidhjes

<b>Drejtoria</b>	<b>Në proces</b>	<b>Miratuar</b>	<b>Refuzuar</b>	<b>Hedhur poshtë</b>	<b>Pezulluar</b>	<b>Totali</b>
Kuvendi i Komunës	7	10	2	0	0	<b>19</b>
Kryetari i Komunës	2	45	5	0	0	<b>110</b>
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	5	240	15	2	3	<b>265</b>
Drejtoria për Administratë	26	52398	11	224	30	<b>52689</b>

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim	11	109	0	0	0	<b>120</b>
Drejtoria për Buxhet dhe Financa	144	220	20	0	0	<b>384</b>
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	8	397	227	1	0	<b>633</b>
Drejtoria për Urbanizëm Mbrojtje te Ambientit	377	8261	50	33	2	<b>8723</b>
Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim Rural	5	1102	0	3	0	<b>1110</b>
Drejtoria për Arsim	33	347	587	2	0	<b>969</b>
Drejtoria për Shërbime Publike	2	64	200	15	6	<b>287</b>
Zyra Lokale e Komuniteteve	4	25	4	0	0	<b>33</b>
Drejtoria per Inspektion	0	114	0	0	0	<b>114</b>
Drejtoria e Prokurimit	8	14	7	0	0	<b>29</b>
Zyra Ligjore	0	114	0	0	0	<b>114</b>
Njësia e Auditimit të Brendshëm	0	8	0	0	0	<b>8</b>
Zyra për të Drejtat e Njeriut	0	5	2	0	0	<b>7</b>
Drejtoria për Gjeodezi e kadastër	58	7812	11	108	0	<b>7989</b>
Zyra për Integritet Evropiane	0	2	0	0	0	<b>2</b>
Zyra e Personelit	6	225	122	8	0	<b>361</b>
<b>GJITHSEJ</b>	<b>696</b>	<b>71882</b>	<b>1341</b>	<b>401</b>	<b>41</b>	<b>74361</b>

#### Sektori për Punë të Përbashkëta dhe Teknologji informative

Shërbimi për teknologji informative ka asistuar vazhdimisht Zyrës së informacionit lidhur me mirëmbajtjen e faqes zyrtare të komunës në internet si dhe avancimin e saj. Gjithashtu i është ofrua mbështetje personelit lidhur me përdorimin e aplikacioneve si: intraneti, e-Pasuria, e-Arkiva dhe ueb faqes së komunës. Janë ndërmarrë veprime lidhur me hapjen e email-ave zyrtar sipas kërkesave të nëpunësve komunal.

<b>Përshkrimi i punëve dhe detyrave të kryerat nga shërbimi për teknologji informative</b>	
Formatizime, instalime të aplikacioneve apo softuerëve të ndryshëm apo zgjedhja e probleme softuerike	167
Mbështetje për personel në shfrytëzimin e resurseve të teknologjisë informative.	137
Zgjedhja e problemeve dhe defekteve teknike të ndryshme.	70
Backup i (ruajtja e të dhënave) aplikacioneve.	229
Mirëmbajtja e ueb faqes.	104

Gjatë kësaj periudhe zyrtari i pranimit (logjistikës) ka proceduar 3385 lëndë për pagesë për shërbime, mirëmbajtje, pagesat e komunalive dhe të gjitha lëndët e prokurimit që janë për pagesë. Shërbimi i lekturimit gjatë kësaj periudhe kohore ka lekturuar 105 dokumente të ndryshe për të gjitha organet dhe shërbimet e administratës komunale si: procesverbale, vendime, rregullore, urdhëresa, raporte, informata e dokumente tjera. Shërbimi i përkthimit gjatë kësaj periudhe ka përkthyer 239 dokumente të ndryshme, për nevojat e administratës komunale si procesverbale, kërkesa, njoftime, vendime, ankesa etj. si dhe ka asistuar me përkthim simulant nëpër takime të ndryshme në 140 raste.

### Zyra për të drejtave të njeriut

Zyra për të drejtave të njeriut ka koordinuar, udhëheq dhe mbikëqyr politikat në komunë në fushën e të drejtave të njeriut, duke përfshirë respektimin e politikave për barazinë gjinore, të drejtave të komuniteteve, përdorimin e gjuhëve, mundësitë e barabarta, zbatimin e politikave për personat me aftësi të kufizuara, të drejtave të fëmijëve kundër diskriminimit dhe antitrafikimit. Kjo njësi ka pasur katër vizita në ZLK, 16 vizita komunitetit rom dhe ashkali, pesë vizita komunitetit serb në fshatrat serbe, qëllimi i vizitave integrimi i komuniteteve në shoqëri si dhe ka shqyrtuar ankesën e komunitetit rom si dhe vizita në 12 shkolla fillore ku u diskutua për sigurinë të drejtat e fëmijëve obligimet e tyre dhe fushata për vetëdijesimin kundër drogës.

Me Lobin për Barazi Gjinore një vizitë jashtë shtetit dhe dy takime me LBGJ komuna e Dragashit

Nga Aureola përfitimin e librave me vlerë 10.000€.

## **Arsimi**

Në këtë raport paraqiten të arriturat dhe sfidat që na kanë përcjellë gjatë vitit 2015 duke pasqyruar punën e DKA-së, drejtorëve, mësimitdhënësve, nxënësve dhe personelit tjetër arsimor, gjatë këtij viti ka pasur suksese dhe sfida në përmbushjen e objektivave të përcaktuara, si në: Përmirësimin e punës pedagogjike-profesionale, trajnimin e mësimitdhënësve dhe drejtorëve, shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të qytetarëve, transportin e nxënësve, bursat komunale pajisja me mjete didaktike për shkolla, mungesa e kabineteve në shkolla etj.

Procesi edukativo-arsimor në komunën Vushtrrisë zhvillohet në këto institucione shkollore: Institucionin parashkollor, çerdhja e fëmijëve “Foleja”, 3 shkolla të plota fillore, 27 shkolla fillore dhe të mesme të ulëta me 16 paralele të ndara fizike, 2 shkolla të mesme të ulëta, 3 shkolla të mesme të larta, 1 shkollë të muzikës, 5 shkolla të komunitetit serb, 1 klasë me 11 nxënës me nevoja të veçanta të moshave të ndryshme deri në 18 vjeç.

Përgatitjet hijeno - teknike dhe për kuadrin arsimor për fillimin e gjysmë vjetorit të dytë 2014-15 u bënë me kohë. Gjysmë vjetori i dytë filloi më 08.01.2015 dhe mbaroi më 20.06.2015.

Gjatë këtij gjysmë vjetori është finalizuar transportimi i nxënësve që janë në distancë më të largët se 4 kilometra nga shkolla dhe anasjelltas (janë gjithsej 29 vija të transportit për nxënës).

#### Niveli 0 (parashkollor dhe parafillor)

Arsimimi dhe edukimi parashkollor në komunën tonë organizohet në kuadër të institucionit parashkollor “Foleja” dhe klasave para fillore publike të cilat ndodhen në shkollat: SHF “Ali Kelmendi”, SHFMU “A.Z.Çajupi”, SHFMU “Lumni Surdulli”, SHF “Mustafë Venhari”, dhe SHFMU “Lumadhi”. Duke pasur parasysh rëndësinë e edukimit dhe arsimimit parashkollor si dhe interesimin e madh të prindërve për regjistrimin e fëmijëve në këtë nivel, DA në Vushtrri, ka lejuar hapjen dhe funksionimin e paraleleve para fillore në kuadër të shkollave, ku ka kushte për punë me këta fëmijë me participim të prindërve.

#### Niveli 1, fillor (klasa I - V)

Gjatë gjysmë vjetorit të dytë të vitit shkollor 2014-15, në nivelin fillor apo 1, që përfshinë klasat nga klasa e parë (I) deri në klasën e pestë (V), kanë qenë 298 paralele me 5564 nxënës (2919 meshkuj dhe 2654 femra) nxënës të regjistruar. Me sukses pozitiv kanë qenë 5546 nxënës ose 99.68% (2905 meshkuj dhe 2641 femra) ndërsa me sukses negativ kanë qenë 13 nxënës ose 0.23% dhe të pa notuar 8 ose 0.13%. Përqindja e suksesit sipas notave: Të shkëlqyer (5) 1841 ose 63.07 % , shumë mirë (4) 572 ose 19.6 % , mirë (3) 369 12.64 % mjaftueshëm (2) 123 ose 4.21%.

#### Niveli 2 (klasa VI - IX)

Përfshin nxënësit nga klasa e gjashtë (VI) deri në klasën e nëntë (IX), në fund të gjysmë vjetorit të dytë të vitit shkollor 2014/2015 kanë qenë 228 paralele me 5292 nxënës (2720 meshkuj dhe 2572 femra). Në këtë nivel me sukses pozitiv kanë qenë 5006 nxënës ose 95.94% (2518 meshkuj dhe 2488 femra), me sukses negativ 286 nxënës ose 5.4% . Disa nga këta nxënës kanë mbetur për t'u riprovuar në afatin e gushtit. Përqindja e suksesit sipas notave: Të shkëlqyer (5) 1727 ose 32.63% , shumë mirë (4) kanë qenë 1158 ose 21.88%, mirë (3) 1440 ose 27.21% mjaftueshëm (2) 681 ose 12.87%.

#### Niveli 3 (kl.X-XII)

Përfshinë klasat nga klasa e dhjetë (X) deri në klasën e dymbëdhjetë (XII). Në fund të gjysmë vjetorit të dytë të vitit shkollor 2014-15 në tri shkollat e mesme të larta kanë qenë 127 paralele me 3238 nxënës. Nga këta nxënës, me sukses pozitiv kanë qenë 2552 ose 78.81%, (1261 meshkuj dhe 1291 femra) kurse me sukses negativ 526 nxënës ose 12.34% (440 meshkuj dhe 205 femra). Pjesë dermuese e këtyre nxënësve kanë mbetur për t'u riprovuar si në afat të qershorit ashtu edhe në afatin e gushtit. 44 nxënës ose 1.3% kanë humbur vitin, dhe të pa notuar janë 41 nxënës ose 1.2%. Ky numër i të pa notuarve është për arsye se mësimi i lartë nuk është i obliguar. Disa nxënës me vetë dëshirë e ndërprejnë procesin mësimor. Përqindja e suksesit sipas notave: Të shkëlqyeshëm (5) 555 ose 17.14 % , shumë mirë (4) 682 ose 21.06%, mirë (3) 978 ose 30.2%, mjaftueshëm (2) 337 ose 10.41%

## Shkolla e ulët e muzikës “Tefta Tashko”, paralelja e ndarë Vushtrri

Gjatë këtij gjysëmvetori në shkollën e muzikës në Vushtrri kanë ndjekur mësimet 74 nxënës (40 meshkuj dhe 34 femra), të shpërndarë në 4 klasë (nga klasa e parë deri në të katërtën).

Në klasën e parë kanë qenë 22 nxënës (15 meshkuj dhe 7 femra), 20 prej tyre kanë sukses të shkëlqyer dhe 2 të shumë mirë.

Në klasën e dytë kanë qenë 18 nxënës (7 meshkuj dhe 11 femra), prej tyre 13 të shkëlqyer, 2 të shumë mirë, 3 të mire.

Në klasën e tretë kanë qenë 11 nxënës (7 meshkuj dhe 4 femra), prej tyre 4 të shkëlqyer, 2 të shumë mirë, 2 të mire dhe 3 të mjaftueshëm.

Në klasën e 4 kanë qenë 23 nxënës (11 meshkuj dhe 12 femra), prej tyre 15 me sukses të shkëlqyer, 5 të shumë mirë, 3 të mire.

Numri i nxënësve të kësaj shkolle nuk mund të përfshihet në kuadër të numrit të përgjithshëm, sepse, nxënësit e kësaj shkolle, janë njëkohësisht edhe nxënës që vijojnë mësimet në shkollat adekuate për të përfunduar arsimin e obliguar me ligj.

### Paralele me fëmijë me nevoja të veçanta

Në komunën tonë është një paralele me fëmijë me nevoja të veçanta me 11 nxënës. Kjo klasë funksionon në shkollën fillore “Ali Kelmendi” dhe me të cilët punojnë dy mësimdhënëse me fakultet pedagogjik special (pedagoge). Gjithashtu, në Çerdhen e fëmijëve “Foleja” janë 4 fëmijë të moshave të ndryshme me nevoja të veçanta, për të cilët, krahas edukatores së grupit, mbështeten edhe nga edukatorja mbështetëse, e cila në orë të veçanta kujdeset për këta fëmijë. Qëllimi i punës profesionale me këta fëmijë është që nëpërmes programeve të përshtatura mësimore të bëhet i mundur integrimi dhe aftësimi gradual i tyre për kyçe në jetën normale. Numri i nxënësve me nevoja të veçanta është 176 nxënës.

### Krahasimi i numrit të nxënësve në fillim të vitit shkollor dhe në fund të gjysmë vjetorit të dytë

Në fillim të viti shkollor kanë qenë të regjistruar 15657 nxënës. Mirëpo, si pasojë e migrimit masiv që pati komuna e Vushtrrisë gjatë muajit dhjetor 2014 dhe janar 2015, nga Vushtrria kanë migruar 852 nxënës. Nga ky numër, janë kthyer 100 nxënës. Kështu në fund të gjysmë vjetorit të dytë të vitit shkollor 2014/2015 në të tri nivelet e arsimit, numri i nxënësve është 14905 (*niveli 0 = 811; niveli 1 = 5564; niveli 2 = 5292; niveli 3 = 3238*). Numri i nxënësve pa nivelin 0 (para fillor) është: 14094nxënës.

### Testi i arritshmërisë dhe i maturës

Testi i arritshmërisë iu janë nënshtruar 1359 nxënës. Nga këta nxënës, të rregullt kanë qenë 1353 dhe 6 kanë qenë me mësim joformal. Rezultati i testit të arritshmërisë ka qenë me një mesatare 71 poena për një nxënës, sepse në këtë test nuk ka prag të kalueshmërisë, d.m.th. të gjithë nxënësit kalojnë. E kthyer në notë mesatare, i bie se ka qenë shumë mirë apo 3,5, që në notë. Përqindja e kalueshmërisë është 52.27%.

### Testi i maturës– afati i parë

Numri i nxënësve që ju nënshtruan testit të maturës ka qenë 1437, të cilët kanë qenë të ndarë në 12 qendra testuese. Në komunën e Vushtrrisë, Kryetarët e Komisioneve të qendrave të maturës kanë qenë nga MASHT-i, mbikëqyrësit nga Podujeve ndërsa administruesit nga Gjilani. Gjatë kohës së mbajtjes së testit të maturës të gjithë drejtorët e shkollave dhe stafi i DA-së ishte i angazhuar me qëllim që testi të mbahet sa më mirë. Në bazë të rezultateve, kalueshmërinë më të lartë, jo vetëm nga tre shkollat e mesme të larta në Vushtri, por edhe në nivel të Kosovës, ka arritur gjimnazi “Eqrem Çabej”, me kalueshmëri 90.38%.

### Testi i maturës – afati i dytë

Testi i maturës pjesa e dytë e afatit të gushtit u mbajt më datë 05.09.2015

Kalueshmëria në këtë afat është 40%. Nga 727 nxënës, testin e kaluan 285 nxënës ose . Kalueshmëria nëpër shkolla është:

Gjimnazi “Eqrem Çabej” nga 59 nxënë kanë kaluar 53 ose 89,83%

SHMT “Lutfi Musiqi” 368 nga 122 ose 33.20%

SHMP “Bahri Haxha” nga 300 nxënës, kanë kaluar 110 ose 36,66%

### Marrëveshje Bashkëpunimi

a. **Marrëveshje** Bashkëpunimi me shoqatën CARITAS, për pajisjen e 5 klasave me inventar (banka, karrigia, lodra dhe mjete didaktike) për para fillor.

b. **Marrëveshje Bashkëpunimi** për Projektin „Rritja e Punësimit për të Rinj” (EYE) që financohet nga qeveria Zvicrane dhe zbatuar nga konsorciumi Helvetas Swiss Intercorporation (HSI). Ku marrëveshja ka për qëllim të fuqizoj funksionimin sa më të mirë të Qendrës për Orientim në Karrier (QOK) e cila do të ofroj dhe promovoj shërbime për orientim dhe këshillim në karrierë, sipas nevojave të tregut për nxënësit e të dy shkollat Profesionale SHMP „Bahri Haxha” dhe SHMT „Lutfi Musiqi”. Shoqata zvicerane “Caritas” ka ndihmuar me 7.500 Euro donacion, për paisjen komplet të pesë klasave parashkollor, në këto shkolla: SHF “Ali Kelmendi”, SHF “Naim Frashëri”, SHF “Mustafë Venhari”, SHFMU “A.Z. Çajupi” dhe Çerdhja “Foleja”.

### Gjysëmvetori i parë 2015/2016

Përgatitjet higjieno-teknike dhe për kuadrin arsimor për fillimin e vitit shkollor 2014 – 15 u bënë me kohë. Viti shkollor 2015 – 16 filloi më 01.09.2015. Sikurse viteve të tjera, edhe në këtë vit shkollor u shpërndanë librat falas nga MASHT-i, përkatësisht Qeveria e Republikë së Kosovës për klasat I - IX. DKA-ja shpërndau librat me kohë nëpër secilën shkollë të komunës sonë. Gjatë këtij gjysmë vjetori ka vazhduar transportimi i nxënësve shkollë shtëpi, i përcaktuar edhe me ligj të arsimit para universitar. Këtë vit ka filluar edhe plotësimi i mjeteve didaktike në disa shkolla që po e lehtësojnë mësimdhënien dhe mësim nxënie.

Zyrtarët e DKA-së kanë marrë pjesë në monitorimin e pothuajse të gjitha shkollave duke përcjellur mbarëvajtjen e procesit mësimor.

Në vitin e ri shkollor 2015-16 në klasën e parë janë regjistruar 1036 nxënës. Në krahasim me vitin e kaluar numri i nxënësve është më i vogël për 85.

Në klasat e dhjeta (X) janë regjistruar 1248 nxënës: Në krahasim me vitin e kaluar, numri i nxënësve në shkollat e mesme të larta, në klasat e dhjeta (X) është për 215 nxënës më i madh (vitin e kaluar kanë qenë 1033 nxënës në klasën e dhjetë).

Në fillim të vitit shkollor 2015 – 16 (shtator), janë regjistruar gjithsejtë 14859 nxënës që në krahasim me vitin e kaluar është 744 më pak.

### Garat e diturisë

Gjatë këtij gjysmëvjetori Drejtoria e Arsimit në koordinim me shkollat dhe shoqatat e ndryshme profesionale që veprojnë në kuadër të komunës, ka organizuar dhe mbajtur disa aktivitete mësimore, kulturore.

U organizuan garat për trashëgimi kulturore nga shoqata CHWB në bashkëpunim me DKA-në dhe DKRS shkollat pjesëmarrëse ishin: SHFMU'' Enver Hadri'' Smrekonicë, SHFMU'' Nazmi Zhegrova'' Stanofc i poshtëm, dhe SHMU-1 Vushtrri, vendin e parë e zuri; SHFMU'' Enver Hadri'' Smrekonicë, ndërsa gara u zhvilluar edhe në mes të tri shkollave të mesëm ku vendin e parë e zuri Gjumnazi'' Eqrem Çabej'' Vushtrri

U mbajtën garat në kolegjin ''Mehmet Akif'' pjesa e parë ku morën pjesë të gjitha shkollat e nivelit 2 nga e VI- IX ndërsa pjesa e dytë do të zhvillohet në gjysmëvjetorin e dytë. Nxënësit e SHF'' Ali Kelemedni'' Vushtrri garuan më Dramë në nivel vendi, ndërsa vendi i parë për aktoren më të mirë i takoi kësaj shkolle nxënëse së klasës së II/1.

Për nder të festës së 28 Nëntorit, shoqata HAI, në koordinim me DA-në, organizoi Kuizin e Diturisë në mes të 5 shkollave : SHFMU'' Rustem Hyseni'' Skromë , SHFMU'' Adem Voca Voca'' Pasomë , SHFMU- Akrashticë, SHFMU- Lumadh, SHFMU'' Zhilivodë dhe nxënësve të shoqatës HAI. Në këtë kuiz, vendin e parë e zuri SHFMU Zhilivodë. Kjo shkollë u shpërblye me 500 Euro nga shoqata HAI, si dhe nxënësit e kësaj shkolle, që përfaqësonin shkollën në kuiz, u shpërblyen me nga 50 Euro. Ndërsa vendi i dytë u shpërblye më tavolinë pingpongu. Gjithashtu, u organizuan gara sportive në futboll në mes të shkollave të lartpërmendura, në ç 'rast vendin e parë e zuri SHFMU-Lumadh, që u shpërblye me një tavolinë pingpongu euro nga shoqata HAI.

## **Shëndetësi dhe përkujdesje sociale**

DSHPS ka realizuar punën e vet në pajtim me legjislacionin në fuqi, objektivat politike dhe në synim të përmbushjes së nevojave të qytetarëve. Gjatë vitit 2015, duke pas parasysh se përmes DSHPS-së, menaxhohen dy sektor të ndjeshëm të siç është shëndetësia dhe mirëqenia sociale, raporti ndahet në dy pjesë, në pjesën për Kujdesin Parësor Shëndetësor dhe pjesën e mirëqenies sociale.

Kujdesi parësor shëndetësor;

Gjatë vitit 2015, Kujdesi parësor shëndetësor përkatësisht objektet shëndetësore përmes së cilave realizohet veprimtari e KPSH-së, janë shënuar këto rezultate;

- Shërbimet shëndetësore janë ofruar për 185.005 pacient, prej tyre 85.617 meshkuj dhe 99.388 femra. Numri i pacientëve këtu është numër për çdo pacientë të regjistruar edhe po që se është i përsëritur.



- Shërbime shëndetësore nga të gjitha shërbimet që ofron KPSH, gjatë vitit 2015 regjistruan 316.969 shërbime, në krahasim me vitin 2014, kemi rritje për 97.532 shërbimeve.
- Referim gjatë vitit 2015 për QKUK apo klinikat përkatëse specialistike, janë shënuar 14.996. në krahasim me vitin 2014, kemi rënie për 2.258 raste.

Po ashtu gjatë këtij vitit janë realizuar projekte sensibilizuese si për stafin mjekësor po ashtu edhe fushata sensibilizuese për qytetarët e komunë sonë për sëmundje të caktuara, përkatësisht, janë realizuar;

- 10 ligjërata nga ZHVP për stafin dhe
- është realizuar fushatë sensibilizuese përmes të gjitha mjeteve të informimit dhe institucioneve shëndetësore e komunale për preventiven nga sëmundja e tularemisë.

Po ashtu gjatë këtij vitit për herë të parë në komunën e Vushtrrisë janë realizuar vizitat sistematike mjekësore për të gjithë nxënësit e shkollave fillore, të mesme të ulët dhe të mesme të lartë. Si rezultat i kësaj pune janë kontrolluar rreth 15.000 nxënës, ku raporti i detajuar dhe i përmbledhur me të gjeturat është botuar si material i veçantë i raportimit.

DSHPS gjatë fillim vitit 2015, ka realizuar hapat konkret për përmirësimin e infrastrukturës si pjesë e rëndësishme e përmirësimit të shërbimeve shëndetësore. Në këtë logjikë është ndërtuar dhe funksionalizuar laborator i cili ka shtuar shërbimet shëndetësore për 5 shërbime të tjera, barnatoren qendrore dhe depon e re. Deri në këtë kohë laborator i ka ushtruar punën në bodrumin e objektit të Spitalit "Sheykh Zaid" ndërsa barnatorja pranë shërbimit radiologjik po ashtu të Spitalit që ka paraqit edhe ndjeshmëri për cilësinë e ruajtjes së tyre.

DSHPS, ka shënuar rritje të theksuar në grumbullimin e të hyrave prej shërbimeve shëndetësore, përkatësisht është viti që ka shënuar rritjen më të madhe, duke grumbulluar 46.438 euro. Përmes kësaj të arriture ka realizuar 92.87% të planifikimit buxhetor.

Gjatë këtij vitit janë realizuar të gjitha investimet kapitale përkatësisht 186.800 euro. Raportimi i detajuar për këto investime është paraqitur në pjesën e investimeve kapitale të Komunës së Vushtrrisë.

### Subvencionet

Në pajtim me Rregulloren për subvencionimin e entiteteve publike dhe jo publike, mundësit buxhetore, vendimet e Kuvendit komunal dhe vlerësimet e komisionit të DSHPS'së, komuna ka subvencionuar entitetet publike dhe jo publike nga fondi 21- të hyrat vetanake dhe nga fondi 10- Grandi qeveritar.

Entitetet publike dhe jo publike të subvencionuara nga fondi për transfere dhe subvencione;

- 8 entitete publike, në vlerë prej 27.500 €.
- 183 entitete jo publike, në vlerë 66.200 euro.

Është e qartë se kemi një numër të konsiderueshëm të rasteve që në mungesë të mjeteve financiare e kemi pas ta pamundur subvencionimin dhe ofrimin e ndihmës për shumë familje apo individ që kanë nevojë. Përpyekja jonë, që sa do pak ti mbulojmë rastet e tilla, ka qenë edhe bashkëpunimi me donatorë, ku si rezultat i kësaj kemi ndihmuar rastet si në vijim;

<b>Nr.</b>	<b>Projekti</b>	<b>Sasia</b>	<b>Donatori</b>
1.	Pako ushqimore	200 familje	Islamic Relief-Kos.
2.	Mish pule (2015)	100 familje	Beni Dona
3.	Pako ushqimore ( 2015)	320 familje	Islamic Relief-Kos.
4.	Mish Kurbani (2015)	320 familje	Rinia Islame - Zvicërr
5.	Mish	400 familje	
	<b>Totali</b>	<b>1.340 familje</b>	

#### Strehimi familjar- subvencionimi i qirave

Pagesa e qirave për familjet në nevojës realizohet në pajtim me procedurat e përcaktuara dhe kriteret e verifikuara nga organet komunale. Asnjë palë nuk mund të sigurojë pagesën e qirasë nga buxheti komunal pa përmbushjen e plotë të kushteve për pagesën e qirasë. Si rezultat i kërkesave, kushteve dhe vlerësimit nga organet e DSHPS, ne sot paguajmë qira për 19 familje në nevojë, në shumë mujore prej 100 euro për qira. Kjo shumë e pagesës së qirasë është në mundësit optimale të buxhetit dhe të kushteve të banimit që ofrohen në komunën tonë.

#### **Qendra për punë sociale**

Qendra për punë sociale veprimtarin e saj e ushtron përmes shërbimeve që i ofron për qytetarët e komunës së Vushtrisë, përkatësisht asistencës sociale dhe shërbimeve sociale.

Asistenca sociale, - Gjatë vitit 2015 janë regjistruar 1348 familje si shfrytëzues të ndihmës sociale përkatësisht, prej tyre 1298 familje me 6079 anëtar janë shqiptar si dhe 50 familje me 135 anëtarë janë minoritete.

Gjatë këtij viti pranë QPS-së në Vushtri kanë parashtruar kërkesë për asistencë sociale 327 familje prej të cilave 112 janë aprovuar, kurse 215 prej tyre janë refuzuar pasi që nuk i kanë plotësuar kriteret ndërsa janë riaktivizuar 37 familje.

Po në të njëjtën periudhë i është ndërprerë asistenca sociale 97 familjeve të cilat ndërkohë kanë qenë shfrytëzues, gjithësej janë refuzuar 312 familje .

Gjatë kësaj periode në komision mjekësor janë dorëzuar dhe trajtuar 1127 aplikantë. Prej tyre janë aprovuar nga KM 813 aplikantë, janë refuzuar 148 aplikantë, ndërsa në rishqyrtim kanë qenë 12.

## Shërbimet sociale

Për periudhën kohore vjetore janë regjistruar këto shërbime sociale; 23 raste të trajtimit të bashkëshortëve me marrëdhënie të çrregulluara ose në procedurën e shkurorezimit, ku prej tyre, 3 raste janë në trajtim e sipër, ndërsa 20 raste janë shkurorezuar me marrëveshje me përjashtim të 3 rasteve. Nga këto familje janë 12 fëmijë, prej tyre 8 i janë besuar nënës në kujdesje, ndërsa 4 iu janë besuar babës në përkujdesje.

Fëmijët pa kujdes prindëror - Kemi pasur dy fëmijë të braktisur të bartur nga viti i kaluar kurse në këtë gjashtë mujor kemi 1 fëmijë të braktisur, 1 fëmijë është vendosur në sos fshati Prishtinë, dhe në këtë vit është bërë adoptimi i tij, 1 është në familje strehuese, dhe një fëmijë është transferuar nga strehimorja Shpresa dhe Shtëpitë e Fëmijëve Kosovë, në Caritas Klinë. Gjatë këtij viti kemi 59 raste kujdestari aktive dhe strehim familjar tek të afërmit 29 raste.

Të miturit me sjellje të çrregulluar dhe delikuent të mitur - Në këtë periudhë janë regjistruar 18 raste të delikuencës së të miturve dhe 4 raste fëmijë me sjellje asociale.

Viktima të trafikimit dhe tentim dhunimit - Gjatë periudhës raportuese kemi 2 rast të të miturve për trafikim, të cilat kanë qenë të vendosura në strehimoren Raba Voca Mitrovicë dhe ku janë rikthyer në familje, nuk kemi raste të rriturave të cilat po ashtu dyshohet për trafikim si dhe raste të abuzimit seksual.

Dhuna në familje -gjatë periudhës së raportimit kemi 16 raste të dhunës në familje, përkatësisht 15 janë gra dhe një fëmijë.

## **Shërbimet publike**

### Sektorit për komunikacion dhe rrugë lokale

Gjatë kësaj periudhe kohore, janë shqyrtuar dhe janë nxjerrë vendimet e nevojshme nga ky sektor, prej tyre: shqyrtimi dhe zgjedhja e një numri të kërkesave të qytetarëve që kanë të bëjnë me ndalim të automjeteve në vende të ndryshme për ngarkim – shkarkim të mallrave, pastaj për parkimin e automjeteve, etj. Është bërë planifikimi i vijave, përgatitja dhe shpallja e konkursit si dhe dhënia e lejeve të punës së bashku me rendin e udhëtimit, kompanive transportuese për bartjen e rregullt publike të udhëtarëve. Kjo është bërë në bashkëpunim të ngushtë me Kompanitë transportuese. Një numër i kërkesave i janë adresuar Ministrisë së Infrastrukturës për mirëmbajtjen verore të rrugëve regjionale, në territorin e komunës së Vushtrrisë. Në këtë kuadër është realizuar projekti për ndërtimin e rreth qarkullimit në udhëkryqin e rrugës magjistrale M2 me rrugët lokale „Ismail Qemali” dhe „Bahri Kuqi”, si dhe vendosja e semaforëve në udhëkryqin e kësaj rruge me rrugën „2 Maji”. I është bërë një analizë e hollësishme gjendjes ekzistuese të komunikacionit në qytet, prandaj është implementuar projekti për furnizimin dhe vendosjen e sinjalizimit horizontal dhe vertikal të komunikacionit në segmentin e parë të rrugës „Ismail Qemali” dhe rr. „Kruja” si dhe në disa rrugë të asfaltuara në fshatra në vlerën prej 10 000 euro. Është bërë mbikëqyrja e kontratës për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve lokale,

Është përpiluar raporti për MAPL për sistemin e menaxhimit të performancës për gjendjen ekzistuese të rreth 15 shërbimeve që ofron Komuna për gjashtëmuajorin e parë dhe për tërë vitin 2015.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur numri i kërkesave, kilometrat e kaluara si dhe karburantet e harxhuara për automjetet e komunës për vitin 2015.

Muaji	Km të kaluara	Litra	Mesatarja
Janar	13536	1465	10,82
Shkurt	15929	1773	11,13
Mars	16669	1771	10,62
Prill	18772	1983	10,56
Maj	19875	2041	10,26
Qershor	19991	2133	10,66
Korrik	16995	1922	11,30
Gusht	15533	1772	11,40
Shtator	14269	1579	11,06
Tetor	20393	2216	10,86
Nëntor	19289	2138	11,08
Dhjetor	16242	1660	10,22
<b>Total</b>	<b>207493 [km]</b>	<b>22453 [l]</b>	<b>10.82 [l/100km]</b>

Në fushën e mirëmbajtjes së gjelbërimit me sukses janë realizuar projektet e planifikuara, si:

Plani për pastrimin, mirëmbajtjen dhe kultivimin e parqeve të qytetit; Plani i ruajtjes dhe mirëmbajtjes së rrethojës, inventarit, gjelbërimit dhe drunjve në parqe; Plani i mirëmbajtjes së stazave dhe rrugicave në parqe; Plani i regjenerimit të luleve dhe barit si dhe kositjen e rregullt të barit. Është punuar edhe në mirëmbajtjen e varrezave të dëshmorëve, martirëve dhe atyre të qytetit.

#### Furnizimi me ujë

Gjatë këtij viti fabrika e re për përpunimin e ujit ka përfunduar së ndërtuari. Pritet që shumë shpejt të filloi furnizimi me ujë të pijshëm për qytetarët e komunës pasi që ky aset tani më i është dorëzuar Kompanisë Rajonale “Ujësjellësi Rajonal – Mitrovica në Mitrovicë. Përndryshe vitin që lamë pas furnizimi me ujë të pijshëm dukshëm është përmirësuar.

Largimi i ujerave të zeza.- gjatë periudhës raportuese filloi realizimi i disa projekteve të ndërtimit të kanalizimit, si në qytet ashtu edhe në shumë fshatra të komunës. Janë përkrahur banorët e lagjeve në qytet dhe fshatra ku nuk ka rrjet të kanalizimit me dhënie e gypave për kanalizim ndërsa puna për vendosjen e tyre është bërë nga komuniteti.

Mirëmbajtjen rrjetit të kanalizimit e bënë kompania e licencuar Ujësjellësi regjional “Mitrovica” -Njësia në Vushtrri, mirëpo, pagesa për ujë është e dobët andaj edhe pjesa për mirëmbajtjen e kolektorëve të kanalizimit është simbolike.

Largimi i ujerave atmosferike.- Gjatë kësaj periudhe është bërë pastrimi i ujëmbledhëseve të prrockave dhe rrjedhave të ujit në qytet.

Hedhurinat - ndërmarrja për menaxhimin e hedhurinave, vepron si Kompani Regjionale “Uniteti” Sh.A. në Mitrovicë, njësi operative në Vushtrri. Kjo kompani me sukses e ka bërë grumbullimin dhe bartjen e mbeturinave. Ndërsa si veprimtari dytësore ka kryer punë të kontraktuara si: pastrimin e rrugëve të qytetit, punë të ndryshme komunale, pastrimin rrugëve nga bora e akulli, etj. Me këtë kompani është lidhur kontrata për larjen e rrugëve, realizimi i të cilës po bëhet me sukses.

Ndriçimi publik –po vazhdon me sukses zbatimin e kontratës për mirëmbajtje të ndriçimit publik në qytet dhe fshatra. Është zgjeruar rrjeti i ndriçimit publik me 2.6 km rrjet në qytet, përkatësisht rrugët: “2Maji”, “17 Qershori” dhe “Hazir Xhaka” me ndriçim modern me 49 trupa ndriçues LED, ndërsa rruga “Azem Galica” është ndriçuar me bashkëfinancim me komunitetin, ku janë vendosur 23 trupa ndriçues si dhe rrugët: “Ekrem Mulaku” dhe “Halim Strovci” janë ndriçuar me nga tre trupa ndriçues secila. Në fshatra janë vendosur gjithsej 120 trupa ndriçues dhe 4.1 km rrjet i ndriçimit publik. Në fshatin Stanoc i Epërm investimet i ka kryer komuniteti ndërsa në fshatrat Lumadh, Stanoc i Poshtëm dhe Prilluzhë lagjia Duraku investimet janë kryer nga Komuna.

Mirëmbajtja e varrezave - Edhe mirëmbajtjes së varrezave, gjatë kësaj periudhe iu kushtua kujdes i merituar. U bë kositja dhe largimi i barit, u punua në mirëmbajtjen e rrethojës dhe punë tjera në varrezat e dëshmorëve, martirëve dhe ato të qytetit etj. Këtë vit tu investua në rregullimin e infrastrukturës së varrezave të qytetit në Begaj, varrezat e martirëve në Vushtrri dhe varrezat e martirëve në fshatin Studime e Epërme. Janë rregulluar rrugët dhe trotualet me kubëza betoni, rrethojë metalike si dhe mbjellja e fidanëve.

## **Urbanizëm dhe mbrojtje të mjedisit**

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2015, janë mbajtur takimet e organizuara nga sektori i planifikimit urban për çështjet e rregullimit urban, pjesëmarrja në konferenca të organizuara nga niveli qendror dhe grupe tjera kombëtare dhe ndërkombëtare, takimet e rregullta me komunitetet e zonave të ndryshme, takimet e rregullta me nivelin qendror rreth vërejtjeve dhe sugjerimeve në hartimin e Ligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje. Sa i përket revidimit të Planit Zhvillimor Urban dhe Komunal DUMM është përkushtuar të bashkëpunoj ngushtë me të gjitha palët e interesuara gjatë procesit të revidimit duke synuar që ky bashkëpunim të reflektohet në dokumentin e planifikimit hapësinor - PZHK. Përfshirja e qytetarëve në këtë proces është mbështetur nga CHWB përmes projektit “Promovimi i pjesëmarrjes aktive në planifikim hapësinor në nivelin lokal”, që financohet nga projekti “Partneriteti për Zhvillim” i USAID ku gjatë kësaj periudhe kohore janë mbajtur 9 diskutime publike (debate me qytetarë) si pjesë e Grupit Këshillues të Komunitetit në lidhje me procesin e revidimit të Planit Zhvillimor Komunal të Vushtrrisë.

Sektori i Urbanizimit - Gjatë kësaj periudhe janë pranuar lëndë prej të cilave janë lëshuar: kushte ndërtimore - 94, informime nga Plani - 9, refuzime për Kushte

Ndërtimore - 29, hedhur poshtë për Kushte Ndërtimore janë - 22, njoftime - 4, pëlqime për subvencione - 5, Informim për plotësim të lëndës - 20, në proces janë 8.

Dalje në teren për punimin e protokolleve pas caktimit të Kushteve ndërtimore - 82 raste  
Dalje në teren për caktimin e pikave - vijës ndërtimore me rastin e dhënies së lejes ndërtimore - 52 raste

Lejet ndërtimore: janë pranuar 120 lëndë kërkesa si: leje ndërtimore të përhershme për: objekte kolektive : 7, objekte ekonomike : 7, objekte banimore: 48, objekt për Qendrën e Mjekësisë Familjare 1. Leje ndërtimore të vazhduara: 2.. Certifikata të Përdorimit:4. Certificate te tjera : 40.

Leje të përkohshme Ndërtimore: 3, Refuzuar: 6. E hudhër poshtë: 1. Në procedurë: 1  
Taksa e mbledhur për Leje Ndërtimore - 311.410,21 €

Ju janë aprovuar kërkesat kompanive si KEDS,TK,IPKO ,PTK për shtrirjen e rrjetit nëntokësor vendosjen e ormanëve MDF vendosjen e shtyllave elektrike dhe inkasomi i te hyrave arrin vlerën në:**14072.00€**

Legalizimi- Faza I. Bazuar në Ligjin Për Trajtimin e Ndërtimeve Pa Leje Nr. 04/L-188, Komuna e Vushtrisë për fazën e parë e ka filluar trajtimin e ndërtimeve pa leje nga nëntori i vitit 2014 deri në qershor të vitit 2015 duke zhvilluar një fushatë të gjërë të vetëdijësimit të publikut përmes radios, internetit, rrjeteve sociale, njoftimeve publike dhe në forma të ndryshme, duke i informuar për mënyrën e aplikimit për legalizim. Gjithashtu janë mbajtur takime me çdo kryetar të bashkësive lokale në mënyrë që ata t'i informojnë bashkëfshatarët e tyre si dhe ju janë shpërndajné fletaplikacione.

Faza II- ka filluar më 16 Shtator 2015 e cila duhet të zgjas deri me 16 Mars 2016. Gjatë kësaj kohe drejtoria ka pranuar vetëm 4 aplikime për trajtimin e objekteve pa leje. Sistemi i Adresave- Krijimi dhe mirëmbajtja e sistemit uniform të adresave është një nga shërbimet më të rëndësishme që pushteti vendor dhe qendror i siguron qytetarëve të Kosovës. Sistemi unik, i saktë dhe i qëndrueshëm i adresave i bën qytetarët më të përgjegjshëm për zbatimin e ligjit, e përmirëson shërbimin ndaj qytetarëve në shërbimet publike e private por edhe në raste emergjencash të operojnë efektivisht. Drejtoria ka përcaktuar adresë unike për çdo objekt të adresueshëm rrugë si dhe do të regjistrojë dhe mirëmbajë të dhënat e adresave, zyrat në sektorin privat dhe qytetarët në Kosovë do të përdorin të dhënat e adresave unike. Lista për emërtim të adresave përmban 1398 rrugë të koduara dhe emëruara dhe lista rezervë me 210 emra.

Spektori për planifikim urban – Kërkesa të qytetarëve 95; Vlerësime të ofertave 44;Pranime teknike të objekteve 20; Mbikëqyrje të objekteve 19; Vlerësim i shtëpive të djegura nga lufta 1; Paramasa dhe parallogari të ndryshme 2; vlerësime në komisione të ndryshme 13;

Menaxhimi i pronës komunale Është përgatitur lista për pronat komunale e cila është aprovuar nga Kuvendi Komunal për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale .Janë pranuar 17 kërkesa nga palët të cilët kanë qenë shfrytëzues të

përkohshëm të tokës ndërtimore për vazhdimin e kontratës, ku të gjitha janë aprovuar. Të hyrat nga shfrytëzimi i përkohshëm i tokës ndërtimore si dhe lokaleve pronë e komunës arrin vlerën në: **37,195.18 €**. Po ashtu janë pranuar edhe 42 kërkesa për shfrytëzimin e hapësirës publike sezonale para lokaleve pronë e komunës. Janë aprovuar 30 prej tyre, ndërsa 7 të tjerat janë refuzuar. Vlera e inkasimit nga hapësirat publike para lokaleve është **5271,50 €**. Për shfrytëzimin e përkohshëm të pronës komunale janë inkasuar gjithsej **44204.58 €**. Në respektim të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës Nr.04/L-144, Rregulloren për procedurat e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale nr.01Nr.19-1/13 të datës 31.01.2013 të gjithë shfrytëzuesit e përkohshëm të pronës komunale janë njoftuar se nuk ju vazhdohen Kontratat e tyre me skadimin e afatit i cili ka qenë deri me 31.12.2015.

#### Spektori për mbrojtje të mjedisit-

Në respektim të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Udhëzimit Administrativ për dhënien e Lejeve Ndërtimore si dhe Rregullores për Tarifa Ngarkesa dhe Gjoha Komunale jemi duke lëshuar Leje Mjedisore Komunale bazuar në Raportin e komisionit profesional të formuar me vendim nga kryetari i komunës z.Bajram Mulaku.

Deri më tani janë lëshuar 12 leje mjedisore dhe janë inkasuar **2900.00 €**

## **Mbrojtje dhe Shpëtim**

Duke u nisur nga kompetencat e komunës sipas Ligjit nr.04/-L-27 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe nga Fatkeqësitë tjera ,Ligji nr.04/L12 për Mbrojtje nga Zjarri, Rregulloren nr.28/2012 Metodologjinë e Hartimit të Vlerësimit të rrezikshmërisë, Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Emergjencave, Drejtoria komunale për Mbrojtje dhe Shpëtim në kuadër të kompetencave të veta, është duke punuar rregullisht ne azhurnimin e planeve si: Vlerësimi i rrezikshmërisë për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera për territorin e komunës, Plani i Gatishmërisë Emergjente, Plani për mbrojtje nga Zjarri, Plani për Evakuimin e personelit nga ndërtesa, Plani për reagim Emergjent gjatë vërshimeve, Plani për Mbrojtje nga Zjarri i ndërtesës së KK.

Qëllimi i azhurnimit të këtyre planeve është: që të bëhet koordinimi i të gjitha shërbimeve për reagim

emergjent në nivel komunal si dhe asistimi i qytetarëve në rast të fatkeqësive natyrore , teknologjike dhe fatkeqësive të tjera; që të kemi një strukturë të koordinuar civile, shërbimet emergjente komunale (shërbimin e zjarrfikësve dhe shpëtimit, shërbimin emergjent komunal medicinal, kryqi i kuqë , OJQ-të ), PK-ën, në mënyrë që këto struktura të jenë të gatshme të reagojnë shpejt dhe me efikasitet në raste emergjente civile.

Me këto struktura jemi në kontakt të përhershëm me qëllim të koordinimit të aktiviteteve në raste Emergjente.

Gjatë këtij viti në DMSH-ë ka pasur angazhime dhe intervenime e sidomos në muajin janar, shkurt, mars dhe maj kemi intervenuar me kompaninë e kontraktuar për angazhim në situata emergjente në teren , janë zhvilluar takime të ndryshme me KFOR-in, me koordinatorin e fabrikës së Lllamarinës Virtyt Ibrahimaga ,ku drejtori i DMSH-së pati takime dhe biseda telefonike të shumta deri sa ne javën e dytë te muajit maj e ka zgjidhë problemin e Fabrikës së Gjatë këtij viti kanë ndodhur dy raste ku qyteti dhe territori i Vushtrrisë është përfshirë nga një mot i ligë me shi të fuqishëm me ç’rast sipërfaqe të shumta dhe prona u përfshin nga vërshimet dhe erëra të forta. Sidomos me dt. 06.02.2015 vërshimet ishin të një intensiteti të lartë dhe vazhduan edhe në ditët në vijim gjegjësisht me 07 dhe 08.02.2015, ndërsa me dt.21 dhe 22 Nëntor territorin e Vushtrrisë e përfshiu një erë e fortë.

Me dt. 06.02.2015 moti i ligë përfshiu gjithë territorin e Vushtrrisë por më të goditura ishin vendbanimet përgjatë rrjedhës së lumenjve dhe prockave. Kjo situatë është menaxhuar nga ekipi i DMSH-së por i përkrahur edhe nga DI dhe DSHP. Përkundër situatës që ka qenë shumë e vështirë rrugët kanë qenë të hapura për qarkullim me përjashtim të rrugës Pestovë-Druar e cila ka qenë e mbyllur për shkak të sasisë së madhe të ujit në fshatin Pestovë dhe Urës në fshatin Prelluzhë e cila lidh fshatrat e artakollit , si dhe segmenti i rrugës në fsh. Ceceli për në lagjen Parduzi.

Ndërsa me dt. 21 dhe 22 11.2015 nga erërat e forta u goditën disa pjesë të qytetit, Smrekonicës, Dalakut, Shtitarices, Sllatines dhe Oshlanit. Në këtë rast komisioni i formuar me vendim të kryetarit me nga një zyrtar nga DMSH-ë , DSHP,DEZHR dhe DK dolën në teren sipas kërkesave të qytetarëve dhe vlerësuan dëmet e shkaktuara në teren.

Prioritetet e DMSH-së për situatën e krijuar; Ndihej dhe shpëtimi i njerëzve, Hapja e rrugëve dhe kanaleve nëpër vende ku mbeturina të ndryshme e kanë bllokuar derdhjen e ujit. Debllokimi i lëshesave dhe kanalizimeve në disa raste



Evitimi i ujit prej shtëpive që kanë qenë të rrezikuara nga vërshimet. Furnizimi me uji të pijshëm për banorët të cilëve iu është ndotur uji i pijes. Vizita mjekësore për banorët e izoluar në rast nevojë.

Gjendja në teren sa i përket intervenimeve të rastet e vërshimeve është përmirësuar dukshëm pas arrijtjes së marrëveshjes me NH “Ibër Lepenc” vitin që shkoi për shfrytëzim të eskavatorit të tyre në këto raste.

### Njësia e Zjarfikësve

Gjatë vitit 2015 kjo njësi ka qenë çdo herë aktive dhe e gatshme për të intervenuar në situata emergjente si në zjarre, vërshime, thatësi, komunikacion etj. Gjithashtu edhe Inspektorët e Parandalimit gjatë kësaj periudhe kanë qenë të angazhuar në kryerjen e detyrave dhe obligimeve në lëmin e parandalimit nga zjarri.

Forma tabelare të gjitha aktivitetet e NJPZSH-së dhe Inspektorëve të parandalimit për periudhën Janar-dhjetor 2015.

N r.	Realizimi I numrit të përgjithshëm të daljeve, struktura e zjarreve dhe int. tjera janar-dhjetor 2015													
	Muaji/ 2015	Nr. i përgjith. i daljeve	Nr. I Zjarreve	Shërbi me	Aks id. rrugor.	Ver sh.	Te rrejsh.	Te lënduar			T e Vdeku r			Gjith esjt
								zj.	qy t.	to t.	zj .	q yt .	to t.	
<b>K O M U N A V U S H T R R I</b>	janar	15	7	8										
	shkurt	20	9	7		4								
	mars	30	21	8	1				3	3		1	1	
	prill	47	33	13			1					1	1	
	maj	61	37	21		2	1							
	qershor	40	26	13			1							
	korrik	136	94	41	1				1	1		1	1	
	gusht	141	106	34	1				4	4				
	shtator	90	72	17	1				11	1				
	tetor	37	22	14	1				2	2				
	nentor	48	30	17			1							
	dhjetor	16	8	8										
Gjithes ejte:	686	469	202	5	6	4			2 1			3		

PASQYRA E NUMRIT TË ZJARREVE NË OBJEKTE NDËRTIMORE-SIPËRFAQJA E DJEGUR

NJPZSH/ KOMUNA VUSHTRRI	SIPËRFAQJA E DJEGUR NE OBJEKTET NDËRTIMORE				
	PERIUDHA:10.01-31.12.2015				
	Në tërësi	Pjesërisht	Shumë pikë		
V I T I  2 0 1 5	Banesa/Shtëpi		3	7	
	Obj. Ndihmëse	1	1		
	Kulme	1			
	Oxhaqe			1	
	Obj. publike	1			
	Obj. biznesi				
	Obj. Industriale				
	Të tjera	3	2	1	
	Gjithsejtë:	6	6	9	

PASQYRA E NUMRIT Të ZJARREVE NË SIPËRFAQE TË HAPUR

NJPZSH/ KOMUNA VUSHTRRI	SIPËRFAQJA E DJEGUR (Hektar)			
	PERIUDHA:10.01-31.12.2015			
	Mali	Bari i thatë	Sipërfaqe bujqësore	Të tjera
	55hektar	100 hektar	3 hektar	50 hektar

Masat e parandalimit nga zjarri

Nr.		Mbe tja 25- 31.1 2.20 14	Tre mujsori I 2015	Tre mujsori II 2015	Tre mujsori III 2015	Tre mujsori IV 2015	Gjithësejt
			01.01- 25.03	26.03- 24.06.	25.06-23.09	24.09-23.12	25.12.2014 dhe 01.01- 23.12.2015
1.	Inspektime fillestare	Festat e funfivit (krishtlindjet dhe viti i ri)	1	-	3	-	4
2.	Inspektime të rregullta		11	13	11	13	48
3.	Inspektime verifikuese		12	13	14	13	52
4.	Persona juridik		14	14	15	12	55
5.	Nr.i objekteve		23	34	16	23	96
6.	Pronësia		2- shoqërore 21- private	2- shoqërore 32- private	8-shoqërore 8-private	/-shoqërore 23-private	84- shoqerore 53-private

			private				
7.	Kategoria I		3	7	1	2	13
8.	Kategoria II		10	14	12	16	52
9.	Kategoria III		1	3	3	2	9
10	Kategoria IV		9	10	-	3	22
11	Nr. masave		48-masa 47-te kryera 1-te pa krye.	44-masa (40- te kryera 4- te pa krye.)	56-masa (45-te kryera 11-te pa krye)	36-masa (34-te kryera 2-te pa krye.)	184 (166- te kryera 18-te pa krye.)
12	Nr.zjarreve	3	32	94	272	66	467
13	Nr.i interv.teknike	2	22	50	90	42	204
14	L. të rrejshme	-	-	3	-	1	4
15	Vëzhgime tereni	-	-	-	-	-	-
16	Vërshime	-	4	2	-	-	6
17	Aksidente	1	2	-			2
18	Nr.i vendshiqimeve	1- vendshiqim	5- vendshiq. 6- vertetime 1-raport	3-vendshi. 4-raporte 4- vertetime	6- vendshiqim e 14- vertetime 3-raporte	5- vendshiqim e 2-vertetime 1-raport	19-vendshi. 26-raporte 9-vertetime 1-plan vjetor

## Kulturë Rini dhe Sport

### Kultura

Ansambl i këngëve dhe valles “Hasan Prishtina”	
Pjesëmarrje në festivale	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Më 07.03. AKV “Hasan Prishtina” mori pjesë në Prekaz , në manifestimin tradicional “Nata e Zjarreve”</li> <li>• 10-16 maj Pjesëmarrja në Festivalin Mbarëkombëtar Folklorik të Gjirokastrës, - (Lidije Pasoma &amp; Shaban Krasniqi me këngë popullore- qytetare).</li> <li>• 17-22 maj Pjesëmarrja në Festivalin “Giresun-Aksu” në Turqi (valltarët)</li> <li>• 21-30 maj në festivalin tradicional të fëmijëve në Stamboll-Turqi , grupi I valltarëve të rinjë (12 vj.) dhe këngëtares Bahare Bunjakut e cila zuri vendin e 4 nga fëmijët e 22 shteteve pjesëmarrëse,(me bashkëpunim me SHBK “Çeshme”.</li> <li>• 14.06. qershor Pjesëmarrja në festivalin tradicional të këngëve dhe valleve “GURRA POPULLORE-2015” në Gjilan, Orkestri ynë u shpallë më I mirë i festivalit.</li> <li>• 19.07. Ansambli “Hasan Prishtina (Driton Vërbovci , Jusuf Pantina dhe Agim Munishi) organizuan program artistik-vokal, Ardi Gashi , Lulëzim Krasniqi si dhe valltarët e Ansambilit, për Ditët e Diasporës.</li> <li>• 31.08. prova gjenerale te Ansambilit , për Akademinë solemne për nderë të Ditës së Dëshmorëve.</li> <li>• 01.09. Kori I Ansambilit me rastin e Ditës së Dëshmorëve , paraqitet me tri këngë korale si dhe dy këngë patriotike.</li> <li>• 27.11. Mbrëmje muzikore në Hotelin “Amazona” për poeteshat,</li> <li>• 28.11. Paraqitja e Ansambilit me disa pika të kushtuar Ditës së Flamurit,</li> </ul>
Manifestimi i ditëve të veçanta	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 17.02. Program kulturo- artistik me rastin e <b>Ditës së Pavarësisë.</b></li> <li>• 02.05 Akademia përkujtimore e <b>masakrës së Studimes</b></li> <li>• 17.06. Program kulturo-artistik me rastin e <b>Ditës së Çlirimit</b></li> <li>• 01.09. Akademi përkujtimore për nderë të <b>Ditës së Dëshmorëve</b></li> <li>• 27.11. <b>Takimet e poeteshave Shqiptare -33 me radhë</b></li> <li>• 28.11. Akademia solemne me rastin e <b>Ditës së Flamurit</b></li> <li>• 11.12. 100 vjetori I shkollës së parë shqipe në Vushtrri</li> </ul>
TEATRI DHE FILMI	
Shfaqje	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 9 shkurt - fillon prova e parë e përgatitjes së komedisë “Burri-Burrë”, provat për realizimin e komedisë janë mbajtur tri herë në javë nga ora 18 e</li> </ul>

teatrale	<p>30;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 17 shkurt - Dita e Pavarësisë së Kosovës, teatri angazhim në moderim dhe poezi;</li> <li>• 15 mars - nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve është pranuar projekti i teatrit “ Hajnat nuk vijnë gjithmonë për të keq”;</li> <li>• 24 mars - angazhim për ditën e bibliotekës,</li> <li>• 2 maj - angazhim në Studime me konferencë dhe me program teatri me oktetin “Coda”;</li> <li>• 22 maj - Dita e martirëve të Vushtrrisë angazhim në teatër, në moderim poezi dhe monolog;</li> <li>• 27 maj - premiera e komedisë “Burri-Burrë”;</li> <li>• 3 qershor – pjesëmarrje në festivalin e komedisë në Mitrovicë;</li> <li>• 4 qershor - repriza e komedisë “Burri-Burrë”;</li> <li>• 11 qershor - moderim dhe monolog teatri në promovimin e librit për Jashar Jasharin, Komandant Durakun;</li> <li>• 15 qershor - fillon prova në teatrin e fëmijëve audicioni i pare, duke vazhduar prapë në shtator për grupin e parë të fëmijëve;</li> <li>• 17 qershor - Dita e çlirimit të Vushtrrisë, teatri angazhim me poezi dhe moderim;</li> <li>• 28 qershor - teatri angazhim me moderim në Ditën e Zonës Operative të Shalës;</li> </ul>
Përfaqësimi i teatrit të qytetit në festivale të ndryshme	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Në festivalin tradicional të komedisë në Mitrovicë më 03.06.2015 shpërblehet Blerta Gubetini me çmimin e aktores që premtan.</li> </ul>

Shënimi i datave të veçanta:

- 17.02.2015 Manifestimi i 6 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës;
- 24.03.2015 U shënua 68 vjetori i hapjes së Bibliotekës “Naim Frashëri”;
- 23.04.2015 Dita ndërkombëtare e librit;
- 02.05.2015 Akademi përkujtimore për të rënë në fshatin Studime në 2 Majin e vitit 1999;
- 22.05.2015 Akademia përkujtimore kushtuar martirëve të vrarë në masakrën e Vushtrrisë 1999;
- 09.06.2015 Shënimi i dhjetëvjetorit të Muzeut;
- 17.06.2015 Dita e çlirimit të qytetit të Vushtrrisë.

- 01.09. 2015 Akademi përkujtimore për nderë të Ditës së Dëshmorëve
- 27.11. 2015 Takimet e poeteshave Shqiptare -33 me radhë
- 28.11. 2015 Akademia solemne me rastin e Ditës së Flamurit
- 11.12. 2015 100 vjetori I shkollës së parë shqipe në Vushtri

Subvencionet

Subvencione të ndara për klubet sportive të komunës Gjithsej: 35.000.00 €.

Subvencione për aktivitete kulturore, rinore dhe sportive

KULT STUDIO	500,00
LEVIZJA KOHA	490,00
KV KOSOVA VUSHTRRI	1.400,00
KH KOSOVA	2.800,00
KF VICIANUM	1.300,00
KOSOVA ARS	300,00
KH SAMADREXHA LUMKUQ	2.800,00
SHOQATA E SHURDHERVE VUSHTRRI	300,00
KV GJIMNAZISTI	1.000,00
KV AS VUSHTRRIA MESHKUJT	1.000,00
KLUBI I KIKBOXING UKA VUSHTRR	800,00
KB KOSOVA VUSHTRRI	1.500,00
KB VUSHTRRIJA BASKET	1.000,00
SHPKFSSHV	300,00
FUN CLUB FORCA	800,00
KH KOSOVA VUSHTRRI	2.800,00
KSH LLAMKOS	600,00
KM KOSOVA VUSHTRRI	500,00

KB KOSOVA VUSHTRRI	2.000,00
KF KOSOVA VUSHTRRI	6.000,00
KH SAMADREXHA EKIPI I FEMRAVE	2.800,00
KLUBI I VOLEJBOLLIT VUSHTRRIA	500,00
SHPSV SHOQATA E PESHKATEREVE	300,00
KB KOSOVA VUSHTRRI	800,00
KP HASAN PRISHTINA	800,00
KSH SHQIPONJA BLETAJE	800,00
KLUBI I BOKSIT VUSHTRRIA VUSHT	300,00
MUHAMET RAMA	300,00
KISCOMS	2.000,00
KKB KOSOVA VUSHTRRI	1.200,00
KSH LLAMKOS	1.500,00
SHOQATA DRITA JONE	2.458,95
KULT STUDIO	500,00
KSH URA E GURIT	300,00
HAREJA QR	480,00
OVL TE UÇK-SE	5.000,00
KP HASAN PRISHTINA	500,00

Subvencione të fituara deri tani

- Projekti “Takimet e Poeteshave” ..... 3000 €  
Financuar nga MKRS.
- Festivali “Kult FEST” ..... 1000 €  
Mbështetur nga MKRS

- Projekti “ Ta pasurojmë Bibliotekën me Libra” ..... 1000 €  
Mbështetur nga MKRS. Me këtë projekt, fituam donacion me libra në vlerë 1000 €.
- Shfaqja teatrale “ Hajnat nuk vijnë gjithmonë për të keq” ..... 6’000 €  
Mbështetur nga MKRS.
- Pranimi i mbi 1350 librave donacione per biblioteken

<b>GALERIA E ARTIT</b>	
<b>Ekspozita</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 07.03. 2015 në Q.K. u organizua ekspozita e nx. të shkollave të mesme dhe parashkollorë me punime të ndryshme nga Arti, për nderë te Ditës së Mësuesit , organizatorët ishin: Drejtoria Komunale e Arsimit në bashkëpunim me DKRS.</li> <li>• 17-20 qershor në Kalan e qytetit, u hap ekspozita figurative me titull” Ne jemi gjithçka...” të Valdete Berishës nga Mitrovica tani jeton dhe vepron në Belgjikë, ekspozita u hap enkas për Ditën e çlirimit të Vushtrrisë.</li> <li>• 10.08.Artistët të rinjë , në Q.K.”Hasan Prishtina” e hapën <b>Muajin e pikturës-2</b></li> </ul>

### **Biblioteka**

<b>Leximi i librave, shtypit si dhe perpunim i librit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ <b>Të dhënat për pjesën e parë të vitit 2015:</b></li> <li>➤ Në këtë periudhë kohore janë përpunuar 750 libra <ul style="list-style-type: none"> <li>• Sektori për të rritur ..... 3632 libra të lexuara</li> <li>• Sektori për fëmijë ..... 6542 libra të lexuara</li> <li>• Shfrytëzues të sallës së leximit 650 studentë.</li> <li>• Lexues të shtypit ditor 742 lexues.</li> </ul> </li> <li>➤ <b>Të dhënat për pjesën e dytë të vitit 2015:</b></li> <li>• Gjatë kësaj periudhë kohore janë përpunuar 747 libra</li> <li>• Në sektori për të rritur janë dhënë për lexim 2616 libra</li> <li>• Sektori për fëmijë janë dhënë për lexim 5240 libra</li> <li>• Shfrytëzues të sallës së leximit kanë qenë 484 lexues.</li> <li>• Lexues të shtypit ditor kanë qenë 805 vetë.</li> <li>• Lexues të rijne për të rritur kanë qenë 113</li> <li>• Lexues të rijne për fëmijë kanë qenë 255</li> </ul>
---	--



<p><b>Ativitete tjera</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 20.01.2015 - promovimi i librit “Pranvera e shpirtit tim”, autore Dafina Musa;</li> <li>• 17.02.2015 - për Ditën e Pavarësisë është organizuar ekspozita nga arti figurativ me temën “Pavarësia”;</li> <li>• 05.03 - promovimi i librit “OAZA E JETËS” e autores Nazmije Zekolli – Mema;</li> <li>• 24.03. - është organizuar “Dita e bibliotekës” e në kuadër të saj , u promovua libri “Vështrim letrar” posmortum Zenun Gjocaj. Në kuadër të kësaj dite gjithashtu u organizua orë letrare dhe hapja e këndit të librave të Zenun Gjocajt;</li> <li>• 08.05. - promovimi i librit “Rrethime nga jeta” autore Verona Hasani;</li> <li>• 11.06. - promovimi i librit “Jashar Jashari- Komandant DURAKU – autor Bedri Tahiri;</li> <li>• Më datë 11.17.2015, me organizim të bibliotekës “Naim Frashëri”, u mbajt promovimi i librit “<i>Jashar Jashari</i>” i autorit Bedri Tahiri, si dhe u organizua ekspozitë me 30 libra të autorit Bedri Tahiri.</li> <li>• Më 11.08.2015 nën organizimin e bibliotekës u mbajt promovimi i librit “<i>Rrëfime nga jeta</i>”, e autorit Verona Hasani, nxënëse e klasës së IX në SHFMU “A. Z. Çajupi” në Vushtrri.</li> <li>• Më 18.09.2015 nën organizimin e bibliotekës “Naim Farshëri” u organizua promovimi i librit “<i>Me pushkë e penë për atdhe</i>”, e autorit Ferid Dibrani.</li> <li>• Më datë 17.11.2015, promovimin e librit “<i>Vite të stuhishme</i>”, e autores Remzie Zekolli.</li> <li>• Më datë 25.11.2015, me organizim të Bibliotekës “Naim Frashëri”, u mbajt promovimi monografisë “<i>Gjykata Komunale në Vushtrri (1945 – 2015)</i>”, e autorit Mustafë Halili.</li> <li>• Më datë 08.12.2015, me organizim të DKRS-së përkatësisht Bibliotekës “Naim Frashëri”, u mbajt promovimi i librit “<i>Lufta e shqiptarëve për autonomi – Kryengritja e Dervish Carës</i>” e autorit Jeton Sallahu.</li> </ul>
-------------------------------	---

<p><b>Donacione (libra të dhuruara)</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pranimi i 653 ekzemplarëve ,</li> <li>• 192 libra nga Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport,</li> <li>• 25 libra nga Byrhan Vilanci – Vushtrri,</li> <li>• 45 libra nga Tefik Mikushnica,</li> <li>• 16 libra nga Ferit Dibrani,</li> <li>• 10 libra nga Dafina Musa,</li> <li>• 17 libra nga Mevlyde Saraçi,</li> <li>• 08 libra shoqata e gruas Gjakove,</li> <li>• 26 libra nga Kadrije Fazliu,</li> <li>• 36 nga Verona Hasani,</li> <li>• 14 libra nga biblioteka “Latif Berisha”- Mitrovicë,</li> <li>• 26 libra nga Halil Kajtazi,</li> <li>• 66 libra nga Hajdar Fejzullahu,</li> </ul> <p><b>Gjatë gjashtë mujorit të dytë të vitit 2015 janë pranuar dhuratë, donacionet etj, 1396 libra (ekzemplarë me tituj të ndryshëm)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 597 ekzemplarë me tituj të ndryshëm, Selatin Novosella i ka dhuruar bibliotekës</li> <li>• 10 ekzemplarë të librit <i>Sonte zemra ime frymon</i>, e autores Ermira Jusufi</li> <li>• 19 ekzemplarë të librit <i>Besoj zemrës sime</i>, e autorit Vëllaznim Hasani</li> <li>• 146 ekzemplarë të librit <i>Pena e gardianit</i>, e autorit Ahmet Dursun</li> <li>• 21 tituj të librave, të dhuruar nga Agjencia Shtetërore e Arkivave – Prishtinë</li> <li>• 53 tituj të librave, të dhuruara nga Tefik Maxhuni</li> <li>• 5 ekzemplarë të librit <i>Vite të stuhishme</i>, të autores Remzije Zekolli</li> <li>• 10 ekzemplarë të librit <i>Gjykata Komunale në Vushtrri 1945 – 2015</i>, të autorit Mustafë Halili</li> <li>• 10 ekzemplarë të librit <i>Lufta e shqiptarëve për autonomi – Kryengritja e Dervish Carës</i>, të autorit Jeton Sallahu</li> <li>• 35 tituj të librave shkencor, dhuruar nga Instituti i Historisë - Prishtinë</li> <li>• 35 tituj të librave shkencor, dhuruar nga Instituti Albanologjik- Prishtinë</li> <li>• 455 ekzemplarë (82 tituj) të librave shkencor, të dhuruar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” dhe Ministria e Arsimit</li> </ul>
<p>Rehabilitimi i fëmijëve</p>	<p>Nga Shërbimi Sprovuesi i Kosovës, Zyra Rajonale e Mitrovicës i ka sjellur të miturit për trajnim, si masë ndëshkuese: Valmir Ahmeti dhe Meriton Ademi poashtu për pjesën e dytë të vitit nga Shërbimi Sprovuesi i Kosovës, Zyra Rajonale e Mitrovicës i ka sjellë të miturit për trajnim, si masë ndëshkuese:</p>

	Fatos Zenunin dhe Mehmet Mehmetin
Libra të dorëzuar bibliotekave ne teren	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Bibliotekës në Maxhunaj ju kanë dorëzuar 129 ekzemplarë me 92 tituj</li> <li>• Bibliotekës në Dumnicë të Llugës 66 ekzemplarë me 52 tituj</li> <li>• Bibliotekës në Samadrexhë 69 ekzemplarë me 52 tituj</li> <li>• Bibliotekës në SHFMU “Adem Voca” në Pasomë 122 ekzemplarë me 104 tituj</li> <li>• Bibliotekës në Smrekonicë 56 ekameplarë me 32 tituj</li> <li>• Burgut në Smrekonicë ju janë dorëzuar 166 ekzemplarë me 42 tituj</li> </ul> <b>GJITHSEJ - 608 ekzemplarë me 374 tituj</b>

### Muzeu

MUZEU	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pajisja e muzeut me programin digjital për inventarizimin e eksponateve.</li> </ul>
PUNËT HULUMTUESE DHE VIZITAT NË TERREN:	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Hulumtimi i artizaneve me qëllim regjistrimi dhe arkivimi të historisë së punës së tyre dhe mjeshtrive artizanale, të cilat i kanë trashëguar dhe ruajtur deri më sot. Si rezultat i këtij hulumtimi janë regjistruar këta artizanë: Faik Ibishi – drugdhendës, Elheme Hasani – punëdore, Xhevrie Haliti – punëdore, Hylkije Xhema – punëdore, Selvete Haziri – punëdore, Fatime Çirezi – punëdore, Hafiz e Ismail Hasani – vegëlpunues, Tafil Hetemi – drugdhendës, Nexhat Shaqiri – fshisëpunues, Sylejman Kurti – vegëlpunues, Emine Tahiri – punime veku</li> <li>• Vizitë hulumtuese në fshatin Reznik me qëllim të identifikimit të dy odave ende funksionale.</li> <li>• Vizita të herëpashërshme dhe kontrollim i monumenteve të trashëgimisë kulturore në komunë – të atyre në qytet dhe rrethinë,</li> <li>• Përmbledhja e punëve hulumtuese të Eposit të Kreshnikëve të zhvilluara nga viti 2012 deri në vitin 2015</li> <li>• Hulumtimi i botimeve të vjetra shkencore nga fusha e trashëgimisë kulturore me qëllim të pasurimit të bibliotekës së muzeut me literaturë profesionale nga vendi dhe rajoni.</li> <li>• Gjatë vitit janë vizituar fshatrat Skromë, Gumnishtë, Boshlan,</li> </ul>

	<p>Vesekofs, Kurillovë dhe Sllakofc për qëllim hulumtimi të kulturës materiale e shpirtërore dhe fotografimit të objekteve të kulturës materiale të paluajtshëm dhe hulumtimit të kulturës materiale së luajtshme – ekspoziteve.</p>
IDENTIFIKIMET:	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Në një shtëpi qytetare janë identifikuar mbi 30-të ekspozite etnografike si shtrojë dhe mbulojë nga tradita qytetare. Familja e cila i posedon këto ekspozite ka pranuar që ato t'ia dhurojë muzeut.</li> <li>• Identifikimi i një këmishe të gjatë pëlhere me motive gjeometrike dhe florale, me vjetërsi mbi 100 vjet dhe shumë e ruajtur. Kostoja e saj është 100 euro, dhe për këtë arsye nuk e kemi në muze!</li> <li>• Në fshatin Sllakoc është identifikuar një hambari mbi 100 vite i vjetër me vlerë të veçantë dhe i disa ekspoziteve tjera me shumë rëndësi për muzeun. Dhe 70 të tjera nëpër fshatrat e komunës së Vushtrisë të cilat synohet që gjatë vitit 2016 të jen pjesë e muzeut</li> </ul>
PASURIMI I FONDIT I SEKTORIT ARKEOLOGJIK:	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Muzeu Historik Etnografik- gjegjësisht Sektori arkeologjik u pasurua me dy ekspozite guri të gdhendura me simbole gjeometrike (kryqa). Ekspozitatet në fjalë janë gjetur dhe dorëzuar në muze nga zyrtarët e Drejtorisë për Urbanizëm.</li> <li>• Gjatë një vizite në Kalanë e Vjetër të Qytetit u identifikuan 28 ekspozite të gjetura gjatë gërmimeve arkeologjike, kryesisht llulla, fragmente qelqi dhe qeramike, etj. Ekspozitatet e lartpërmendura pas konsultimit me zyrtarët nga Instituti për MMK u bartën në muze, të cilat u inventarizuan dhe u arkivuan në Muzeun Historik Etnografik.</li> </ul>
PASURIMI I FONDIT I SEKTORIT ETNOGRAFIK:	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Muzeu Historik Etnografik- gjegjësisht Sektori etnografik u pasurua me tri ekspozite siç janë: një komplet të filxhanëve për kafe nga porcelani, shpatë e vekut dhe bosht për tjerje.</li> <li>• Në kuadër të projektit "Pasurimi i Muzeut me Ekspozite", fondit të muzeut, gjegjësisht sektorit të etnografisë i'u shtuan edhe 120 ekspozite të ndryshme nga veshjet, shtroja dhe mbuloja, qeramika, druri, metali etj.</li> <li>• Gjatë vitit muzeu u pasurua edhe me 7 ekspozite nga ansambli "Hasan Prishtina".</li> <li>• Inventarizimi dhe fotografimi profesional i 132 ekspoziteve të cilat u dhuruan nga nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme në Vushtri.</li> </ul>

PASURIMI I FONDIT I SEKTORIT TË KINOTEKËS DHE FOTOTEKËS:	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pasurimi i Sektorit të fototekës edhe me 14 fotografi të vjetra nga lufta e fundit e 1998-99.</li> <li>• Pasurimi i Sektorit të fototekës edhe me 11 fotografi të vjetra nga jeta familjare e vushtriasve dikur.</li> </ul>
PUNA NË BIBLOTEKËN E MUZEUT	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përpunimi i 174 librave të cilat ishin pjesë e bibliotekës së muzeut.</li> <li>• Pasurimi i Bibliotekës së Muzeut edhe me 240 libra shkencor nga vendi dhe rajoni.</li> </ul>
AKTIVITETET E MUZEUT	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Organizimi i një ekspozite fotografike në bashkëpunim me OSCE-në gjatë muajit gusht ku u ekspozua pasuria kulturore e Kosovës fotografuar nga të rinjtë e Kosovës.</li> <li>• Ndjekja e një trajnimit për "Gude Turistike" (ciceron) në nivel të Kosovës.</li> <li>• Pritja e mërgimtarëve në muze.</li> <li>• Takime me <b>mjeshtërit artizan</b> për qëllim bashkëbisedimi dhe intervistimi lidhur me historinë e punës së tyre dhe mjeshtëritë artizanale që i kanë trashëguar dhe ruajtur deri sot.</li> <li>• Më datën 23 dhjetor 2015, para qytetarëve prezantuar projektet: "Pasurimi bibliotekës së muzeut me literaturë shkencore" dhe "Pasurimi i Muzeut me Ekspozate", projekte këto të realizuara nga muzeu, financuar nga CHWB-ja.</li> </ul>

### **Arkivi**

Shërbimi për mbrojtjen e dokumenteve arkivore jashtë arkivit	Janë inspektuar regjistraturat jashtë arkivit në Gjykatën Komunale-Vushtrri, ku materiali ishte në gjendje të mirë për afërsisht në bazë të rregullave të ruajtjes së dokumentacionit.
Pranimi i lëndës arkivore	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Janë pranuar regjistrat e dokumentacionit të Gjykatës komunale të viteve 1971-1981 ku përfshihen:</li> </ul>
Aktivitete tjera	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b><u>Asgjësimi i materialit</u></b> Në muajin shkurt është asgjësuar materiali i pavlefshëm për kundërvajtje i Gjykatës Komunale-Vushtrri, i viteve 2005-2008 në bashkëpunim me Gjykatën komunale pasi që këtij materiali i skadon afati i ruajtjes 3 vite pas përpilimit të dokumentacionit-dosjeve.</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b><u>Punët e depos</u></b> Materiali i cili gjendet në depot e arkivit është në gjendje të mirë vetëm se mungojnë kushtet e përshtatshme të temperaturës, të cilat janë të kërkuara me Ligjin mbi lëndën arkivore dhe arkivat.</li> <li>• <b><u>Shërbimi ndaj publikut</u></b> Gjatë kësaj periudhe arkivit iu kanë drejtuar 56 kërkesa të ndryshme. <ul style="list-style-type: none"> <li>· vërtetime pronësore <b>30 kërkesa</b> = 20 të kryera 10 mungon dokumentacioni,</li> <li>· vërtetime dosjesh <b>10 kërkesa</b>, 5 prej tyre të kryera 5 mungesë dosjesh,</li> <li>· certifikata të ish-shkollës së policisë <b>4 kërkesa</b> të gjitha të kryera,</li> <li>· të ndryshme <b>12 kërkesa</b> të kryera.</li> </ul> </li> </ul>
--	---

## **Rinia**

Takime dhe aktivitete të rëndësishme	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 20.01.2015 – Janë njoftuar të gjitha OJQ-të rinore për aktivitetet kulturo-artistike që do të mbahen në kuadër të festimit të Ditës së Pavarësisë,</li> <li>• 22.05.2015 - është mbajtur aksioni “Ta pastrojmë Kosovën”. Po ashtu si edhe herëve tjera në këtë aksion morën pjesë edhe shumë të rinj, ku bashkërisht me ta pastroam sheshin e qytetit.</li> <li>• 25.05.2015 – Takim me përfaqësues të OSBE-së. Në këtë takim ata shprehën gatishmëri që të mbajnë disa trajnime për të rinjtë vushtrrias në fusha të ndryshme: Trajnim për shkruarjen e projekteve. Trajnim për ndërmarrësit e rinj. Komunikim dhe avoki</li> <li>• Më 12.06.2015 - është themeluar kuvendi i të rinjve Vushtrrias.</li> </ul>
Realizimi i Projekteve	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 17.02.2015 - OJQ “Kult Studio” përkrahur nga DKRS, ka implementuar projektin për festimin e Festës së pavarësisë.</li> <li>• 03.04.2015 – OJQ “Kosova SERVAS” në bashkëpunim me DKRS, si dhe NASA-në ka implementuar projektin “International space apps challenge”. Ky projekt kishte për qëllim promovimin e teknologjisë dhe inovacionit, kurse fushat specifike të këtij projekti kanë qenë: Hapësirë kozmike, robotikë, njerëzit, toka.</li> <li>• 01.05.2015 - DKRS ka përkrahur festivalin “KULT FEST” të organizuar nga OJQ – “Kult Studio” të mbajtur në Sllakoc. Ky aktivitet kishte për qëllim promovimin e turizmit, si dhe argëtimin e të rinjve,</li> <li>• 09.05.2015 – Në rastin e Ditës së Evropës - 9 Majit, u mbajtën disa aktivitete kulturo-artistike në Kalanë e qytetit. Këto aktivitete u mbajtën për fëmijët me nevoja të veçanta, si dhe minoritetet. Qëllim kryesor i këtij aktiviteti ishte socializimi i kulturave të</li> </ul>

	<p>ndryshme të komuniteteve, të cilat jetojnë në Kosovë dhe aktivitetet e tilla u organizuan në bashkëpunim me shoqatën “Ad-Libidum”</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 11.06.2015 – DKRS në bashkëpunim me KVRL-në, si dhe Qendrën rinore, ka hartuar Planin e Veprimit Rinor Lokal, në të cilin plan janë hartuar politikat rinore të komunës tonë për periudhën 2016 – 2018, dhe po i njëjti plan pritet të miratohet në Kuvend dhe të bëhet i plotfuqishëm.</li> </ul>
--	--

## Sporti

Rezultatet në fushën e sportit janë të shumta dhe mund të gjenden në raportin e Drejtorisë për kulturë rini dhe sport. Duke qenë se ato janë të paraqitura në dhjetëra faqe kemi konsideruar të panevojshme për ta ngarkuar këtë raport të dhëna të tilla.

<p>Aktivitetet tjera sportive të organizuara në kuadër të DKRS-së:</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Turne i hapur në Pingpong për nder të 7 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, i cili u mbajt më 15.02.2015 në Palestrën e sporteve “Jeton Tërstena” Vushtrri, në ç’ rast u ndanë 9 kupa, 36 medalje dhe 36 mirënjohje.</li> <li>• Në përvjetorin e të rënëve në Masakrën e Studimes 99, është organizuar turne shahu me 93 pjesëmarrës, prej të cilëve 8 ishin nga Novi Pazari, 2 nga Presheva, 2 nga Maqedonia, 1 nga Shqipëria, kurse të tjerët nga Kosova. Me këtë rast u ndanë 4 kupa, shpërblime me para për 5 vendet e para, si dhe për pjesëmarrësin e ri më të suksesshëm.</li> <li>• Turne Basketbolli për grup moshat e reja në kuadër të 1 Qershorit –Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve. Pjesëmarrës: KBB “Vushtrria Basket”, KBB “Liria” nga Shkupi dhe KBB “Prishtina”.</li> <li>• SHPKF SSH-Gara shkollore (më 15.04; 17.04; 21.04; 24.04; 05.05; 14.05; 15.05; 18.05; 21.05; 22.05; 29.05.2015).</li> <li>• Federata e Hendbollit e Kosovës-Kampionati i Juniorëve (Më 12.04; 03.05; 16.05 dhe 13.06.2015).</li> <li>• Federata e Basketbollit e Kosovës-Kampi i përfaqësueses U-21 nga data 01.06-10.06.2015, nga dy termine në ditë.</li> <li>• Federata e Volejbollit e Kosovës-Kampionati i grup moshave të reja (më 06.06 dhe 07.06.2015).</li> </ul>
--	---

## Inspekcioni

Drejtoria Për Inspektime - Vushtri gjatë kësaj periudhe aktivitetet e veta i ka përqendruar në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë dhe akteve tjera nënligjore me qëllim të krijimit të kushteve sa më të mira për rend dhe rregull në të gjitha fushat në komunën e Vushtrrisë.

Inspektorati i Tregut Qëllimi i inspektimit : Siguria e përgjithshme e produkteve, të gjithë personat që merren me afarizëm tregtar ta kenë parasysh që afarizmi i tyre tregtar të jetë në nivel , duke ju përshtatur Ligjeve në fuqi dhe këshillave apo masave preventive, luftimi i praktikave të padrejta tregtare si dhe parandalimi i tregtisë informale, mbrojtja e konsumatorit, mbrojtja e shëndetit publik duke kryer kontrolla të rregullta në sigurinë e përgjithshme të produkteve, Respektimi i orarit të punës nga ana e subjekteve ekonomike, Udhëzime, këshilla tek subjektet ekonomike mbi Ligjet në fuqi si dhe për Ligjet e aplikueshme që rregullojnë praktikën tregtare si dhe çështje të tjera që ndikojnë në zhvillimin e tregtisë e që janë të aplikueshme me Ligje dhe qëllimi kryesor të merren të gjitha masat për parandalimin e tregtisë informale

Inspektorati i Tregut me qëllim të sensibilizimit të opinionit mbi të drejtat që ju garanton Ligji Për Mbrojtjen e Konsumatorit , si dhe realizimit të aktiviteteve në “Javën e Konsumatorit” ka bërë informimin dhe vetëdijesimin e konsumatorëve mbi të drejtat e tyre konform Ligjit, e njëkohësisht janë kryer inspektime në subjekte afariste .

Inspektimet kanë qenë të rregullta ndërsa nga ana e inspektorëve janë dhënë vërejtjet duke i eliminuar parregullsitë e gjetura tek subjektet afariste me afat MENJËHER.

Gjatë kësaj periudhe janë inspektuar subjekte ekonomike : subjekte afariste ku frekuentimi i konsumatorëve është më i madh subjekte afariste me te vogla qe shesin mallra ushqimore subjekte afariste qe shesin mallra jo ushqimor (teknik të bardhë),barnatoret farmaceutike.

## Inspektorati Sanitar

Inspektimi i të gjitha subjekteve të cilat merren me shërbime, librezat sanitare, mallrat me afat të skaduar, ekspozimet e mallrave jashtë dyqaneve, uniformat e punës.

Janë inspektuar të gjitha subjektet afariste, të cilat merren me afarizëm të gjërave ushqimore, Marketet, Qebaptoret, Gjellëtoret, Spitalet, Ordinancat private dhe shoqërore, Furrtarët, Kafiteritë, Shkollat etj.

Gjatë inspektimeve rutinë kemi urdhëruar dhe këshilluar bizneset që të aplikojnë sistemin e vetëkontrollit të produkteve të ndryshme ushqimore që është e paraparë edhe me Ligjin Për Ushqimin Nr.03/L-016 ku një praktikë e tillë ka ndikuar tek bizneset në largimin nga tregu të produkteve dhe kanë bërë kërkesën për asgjësim (këtu përfshihen produktet e dëmtuara dhe me afat të skaduar).

Në bashkëpunim me inspektoratin e Tregut tek disa subjekte afariste janë gjetur mall me afat të skaduar, këto mallra janë larguar nga shitja dhe të njëjtat janë asgjësuar në prani të pronarëve të subjekteve afariste.

Në bashkëpunim me inspektorët e sektorëve tjerë janë larguar shitësit në rrugë të ndryshme ambulativë nga rrugët e qytetit: “Mic Sokoli”, “Ë. Clark”, dhe te tregu i gjelbër.

Për të gjitha subjektet afariste të cilat kanë qenë në kundërshtim me Ligjet në fuqi Udhëzimet Administrative e që është konstatuar në procesverbal janë urdhëruar që të evitojnë parregullsitë në afat të caktuar kohor.

Subjektet afariste të cilat nuk kanë zbatuar urdhëresat në afat të caktuar kohor është ngritur Procedurë për Kundërvajtje në Gjykatën Kompetente.



Inspektorati i Ndërtimit, Mbikëqyrjen e lejeve të ndërtimit, ndërtimet pa leje, vendosjen e pikave ndërtimore. Janë kryer inspektime për ndërtimet pa leje dhe janë marrë masa për ndalimin e punimeve pa leje ndërtimore deri në aplikimin, përkatësisht pajisjen me leje ndërtimore .Ndaj personave përgjegjës të ndërtimit të cilët nuk janë paisur me leje ndërtimi ,është inicuar procedura kundërvajtëse pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë dega në Vushtrri. Gjatë lëshimit të lejeve për ndërtim kemi marrë pjesë edhe në caktimin e pikave, së bashku me zyrtarët nga Drejtoria e Urbanizimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit. Janë rrënuar 7 objekte të cilat kanë paraqit rrezik për jetën e qytetarëve si dhe për ndotjen e Mjedisit, si dhe materiali i demoluar nga rrënimi është larguar nga hapësira publike. Rrënimi i këtyre objekteve është rrënuar me vendimin e organit përkatës. Për mos pajisje me leje ndërtimi janë rrënuar 5 objekte të cilat kanë qenë duke u ndërtuar . Kemi pasur bashkëpunim me Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Në bazë të Ligjit dhe udhëzimeve administrative kemi bërë inspektimin e objekteve me ndërtim të lartë nëpër çdo fazë të ndërtimit, ashtu siç është parashtruar kërkesa nga investitori dhe si është e përcaktuar me ligj. Për çdo fazë të ndërtimit janë plotësuar edhe formularët e ndërtimit dhe në bazë të këtyre formularëve objektit banesor – afarist pronarëve të objekteve të ndërtuara ju është dhënë pëlqimi për Lejen e Përdorimit për shfrytëzim , pasi që janë plotësuar të gjitha kushtet dhe kriteret për shfrytëzim.

Inspektorati i Komunikacionit, Inspektimi i transportuesve, Taxi, autobusëve, kontrollimi i transportuesve tjerë që merren me transportimin e mallrave të ndryshme. Gjatë vitit janë kryer 324 aktivitete inspektuese. Inspektorët e komunikacionit kanë kryer edhe veprimtari tjera brenda Drejtorisë për Inspektime kryesisht në largimin e shitësve ambulantiv në hapësirat publike si dhe gjatë ditëve të tregut rregullisht të angazhuar në largimin e shitësve nga rruga .Bashkëpunimi me Policinë e Kosovës njësia në Vushtrri si dhe Policinë e Kosovë –Trafiku rajonal ku bashkërisht janë kryer inspektime në komunikacionin rrugor. Në pjesën e dytë të vitit 2015 është organizuar një aksion nga Ministria e Infrastrukturës gjegjësisht Inspektorati i Transportit dhe Policia e Kosovës Njësia e Trafikut , me ftesë të Ministrisë së Infrastrukturës kemi qene pjesëmarrës edhe ne Inspektorët e Komunikacionit . Kryesisht ky aksion është zhvilluar në Magjistralen Prishtinë-Mitrovicë. Gjatë këtij aksioni janë marre masat e nevojshme me qëllim të eliminimit të transportuesve ilegal .Ky aksion ka pas për qëllim në përmirësimin e transportit të rregullt të udhëtarëve në këtë relacion

#### Inspektorati i Higjienës Komunale –Shërbimeve Publike

Janë kryer kontrollime dhe inspektime të vazhdueshme duke ndërmarrë të gjitha masat administrative me qëllim të parandalimit të papastërtisë të rrugëve të qytetit dhe rrethinës; të rrjedhjes së kanalizimeve dhe fekaleve, papastërtisë së sipërfaqeve të gjelbëruara publike dhe terreneve sportive, papastërtisë rreth objekteve banesore nga hedhurinat e banorëve e tjera. Mbikëqyrjen e pastërtisë të qytetit me rrethinë dhe objektet komunale me qëllim të ngritjes së cilësisë të higjienës në Komunën tonë. Angazhim ka qenë i drejtuar edhe në mbikëqyrje ditore të mbajtjes së pastërtisë të rrugëve dhe përcjelljes e bartjes së hedhurinave të kontejnerëve të vendosura nga KRM –Uniteti .

Edhe përkundër që këtë vit kemi një infrastrukturë shumë më të mirë në krahasim me vitet paraprake në vazhdimësi janë mbikëqyrë rrjedhjet e ujit, kanalizimit si dhe parregullsi të tjera të konstatuara gjatë punës në teren. Mbikëqyrjen e pastërtisë së sipërfaqeve të gjelbëruara publike. Gjatë sezonit dimëror janë marr masa në vazhdimësi rreth përcjelljes së pastrimit të borës para lokaleve afariste.

Përcjellja e realizimit të nivelit të pastërtisë nga KRM “ Uniteti” si dhe për zgjidhjen e kërkesave të ndryshme brenda afateve ligjore të adresuara nga qytetarët .

Inspektorati i Mjedisit. Janë ndërmarrë aktivitete në lëmin e mbrojtjes së mjedisit me qëllim të krijimit të një mjedisi më të pastër, më të sigurt dhe më të shëndosh për të gjithë qytetarët. Për realizimin e këtij qëllimi është kryer analiza në lëmin e ndërgjegjësimit ambiental dhe edukimit me qëllim të krijimit të gjitha mekanizmave dhe të instrumenteve të mundshme që nevojiten për të krijuar një program të përhershëm për vetëdijesim dhe edukim mjedisorë. Janë kryer 325 inspektime, raporte javore (43), propozime, komunikata, Informata (5), urdhëresa (71), procesverbale (53), njoftime (5), pëlqime (1), kërkesa Gjykatës për Kundërvajtje (2), Dënime mandatorë (5) Gjatë kësaj periudhe është realizuar një bashkëpunim të ngushtë me Inspektorët e Ndërtimit, Inspektorin Sanitar, Inspektorët e Shërbimeve Publike, Inspektorët e tregut, Menaxherin për hedhurina nga KRM “Uniteti” Sh.A Mitrovicë njësia në Vushtrri, KRU “Mitrovica” Sh.A. njësia operative Vushtrri, Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Drejtorin e Shërbimeve Publike, Drejtorët e shkollave fillore dhe të mesme, OJQ – të Mjedisore dhe me qytetarë. Gjatë muajit prill, muajit të higjienës kemi marrë një aksion gjithë përfshirës me të gjitha institucionet relevante për pastrimin e mjedisit si dhe kemi bërë gjelbërimin e disa. Çantat janë siguruar nga MMPH dhe janë shpërnda falas qytetarëve me qëllim të vetëdijesimit dhe sipërfaqeve ku ka pasur mundësi. Me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Tokës janë shpërnda çanta biodegraduse mbrojtjes së mjedisit. Në bashkëpunim me KRM “Uniteti” dhe drejtorin e Shërbimeve Publike kemi marrë një aksion për eliminimin e deponive ilegale të mbeturinave në disa rrugë të qytetit si dhe në magjistrale. Në bashkëpunim me Drejtorinë e Emergjencës dhe njësinë e zjarrfikëseve kemi inspektuar fabrikën e lllamarinës Llamkos Galvasteel Core Grup në Vushtrri. Është konstatuar se temperatura në rezervarët e amoniakut është ngritur në nivelin më të lartë për shkak të temperaturave të larta. Andaj për t’i ikur ndonjë rreziku kemi intervenuar me njësinë e zjarrfikëseve për ta ulur temperaturën e rezervuarëve. Me qëllim të mbrojtjes së mjedisit Komuna e Vushtrrisë me Drejtorinë për Punë dhe Mirëqenie Sociale është marrë aksioni për pastrimin e mbeturinave nga shëtitorja e qytetit dhe nga shtrati i lumit “Tërstena”. Ndërsa aksioni për pastrim të lumit “Studimja” në fshatin Studime e Ulët është duke vazhduar në largimin e mbeturinave të grumbulluara në shtratin e këtij lumi.

Paraqitja tabelare

Inspektorati	Procesverbale	Fletparaqitje	Aktvendime / udhëresa	Mbyllje të lokaleve përkohsishtë	Gjoha mandatore
Inspektorët e Tregut 4	547	7	24	6	
Inspektori Sanitar 1	167	6	45	1	
Inspektorët e Ndërtimitaris 2	107	38	86		
Inspektorët e Komunikaci. 2	193	9	44		
Inspektori i Mjedisit 1	53	2	71		5
Inspektorja e higjienës 1	11	2	123		2
Totali	1078	64	393	7	7

SUBJEKTE AFARISTE TE PAJISURA ME AKTVENDIM MBI PLOTËSIMIN  
KUSHTEVE MINIMALE TEKNIKE - Inspektorati i Tregut

APLIKUAR	102
----------	-----

TË VENDOSURA	102
NË PROCEDURË	-
Mjete të inkasuara në €	4670,00 €

PRANIME TEKNIKE NGA AUTOMJETET  
Inspektorët e Komunikacionit

APLIKUAR	44
TË VENDOSURA	44
NË PROCEDURË	-
Mjete të inkasuara në €	250,00 €

PËLQIME SANITARE - Inspektori Sanitar

APLIKUAR	106
TË VENDOSURA	106
Mjete të inkasuara në €	10295,90 €

Gjoha mandatore të aplikuar nga ana e Inspektoratit

TË APLIKUARA	9
TË VENDOSURA	9
Mjete të inkasuara në €	400,00 €

Malli i larguar nga shitja dhe qarkullimi dhe mall i asgjësuar nga  
Inspektorati i Tregut dhe Sanitar

Mall i asgjësuar vlera në euro	18815,58 €
Mjete të inkasuara nga asgjësimi i mallrave	500,00 €

Largimi – rrënimi i objekteve pa leje ndërtim  
Inspektorët e Ndërtimit

Rrënimet të objekteve	12
-----------------------	----

Kërkesa të ndryshme

Kërkesa të pranuar	509
Kërkesa të shqyrtuara	484
Kërkesa të refuzuara	25
Në procedurë	-

TË HYRAT NGA DREJTORIA PËR INSPEKTIME

Dënime Mandatore	230,00
Pëlqime Sanitare	4772,69 €
Pranime teknike	5810,00 €
Mallra të asgjësuar	1420,00 €
Veterinaria	5361,15 €
Pranime teknike nga komunikacioni	240,00 €
Totali i përgjithshëm i të hyrave	17833,84 €

## **Gjeodezi Kadastër dhe Pronë**

Nr.	LENDET E ARRITURA Janar- dhjetor 2015	Gjithsejte
1.	KERKESAT E ARRITURA	<b>7988</b>
2	AKTVENDIME PER BARTJE	<b>962</b>
3.	AKT. PER KORRIGJIMIN E EMRAVE DHE MBIEMRA.	<b>122</b>
4.	AKTVENDIME PER REGJISTRIMIN E HIPOTEKAVE	<b>131</b>
5.	AKTVENDIME PER CREGJISTRIMIN E HIPOTEKAVE	<b>50</b>
6.	VERTETIME-CERTIFIKATA	<b>1122</b>
7.	COPTIMI-NDARJE FIZIKE	<b>69</b>
8.	INQIZIMI I GJENDJES FAKTIKE	<b>8</b>
9.	EKSPERTIZA GJYQESORE	
10.	KOPJE TE PLANIT	960
11.	LISTA POSEDUESE	6562
12.	KERKESA ZYRTARE TE NDRYSHME	<b>68</b>
13.	UZURPIMET dhe shpronësime	<b>6</b>
14.	LENDET NE PROCEDURE	<b>28</b>
15	Kërkesa tjera(identifikim, dalje ne teren, ankesa etj).	<b>151</b>

Gjatë periudhës raportuese përveç për palë tjera, janë kryer punë të ndryshme edhe për nevoja të Komunës, gjegjësisht të drejtorive tjera gjatë realizimit të projekteve të ndryshme (asfaltim të rrugëve, rregullim të trotuareve, lirim të hapësirave publike etj.)

### **Informimi**

Tashmë më shumë se një dekadë Komuna e Vushtrrisë, ka krijuar një traditë të mirë të informimit dhe komunikimit me qytetarë si dhe transparencës e llogaridhënies. Por përveç vazhdimësisë në këto fusha, në vitin 2015 Zyra e Komunikimit me Publikun (ZKP) ka zgjeruar

bashkëpunimin me partnerë të jashtëm si MAPL-në dhe organizata ndërkombëtare. Komuna e Vushtrrisë - ZKP ka marr vlerësime pozitive si nga institucionet qendrore MAPL, ashtu edhe nga organizatat e ndërkombëtare si USAID, OSBE dhe organizata jo qeveritare kosovare që merren me monitorimin e pushtetit lokal. Nga raporti i MAPL-së për funksionimin e Komunave të Kosovës, Komuna e Vushtrrisë ka marr vlerësime shumë pozitive lidhur me transparencën dhe llogaridhënien. Përveç publikimit 100 % të gjitha aktet dhe dokumentet e nxjerra nga Kuvendi Komunal dhe administrata lokale, këtë vit janë është rritur numri i dokumenteve të politikave publike të Komunës. Gjatë vitit 2015 nga Zyra e Komunikimit me Publikun në Ueb faqën zyrtare janë publikuar gjithsejtë 250 lajme. Po asq në rrjetin social, në faqen zyrtare të Facebook-ut.

Është shënuar progres në fushën e Transparencës komunale. është shënuar një pjesëmarrje më e madhe e qytetarëve në diskutimet e politikave publike hartimin e strategjive, planeve e rregulloreve, por edhe në takimet e kryetarit të Komunës me qytetarë, ku këta të fundit kanë diskutuar për investimet por edhe kanë shprehur interesimin e tyre për përmirësimin e infrastrukturës dhe kushteve për jetë më të mirë. Gjatë monitorimit të Komunës së Vushtrrisë është vërejtur se kjo komunë është mjaft transparente duke publikuar buxhetin për vitin 2015, raportin përmbledhës për vitin e kaluar fiskal, raportin tre mujor të shpenzimeve, kornizën afatmesme të buxhetit, listën e projekteve kapitale, si dhe janë mbajtur dëgjimet publike para miratimit të buxhetit”, thuhet në Raportin e MAPL-së për monitorimin e Komunave të Kosovës për vitin 2016. Po ashtu në këtë vit janë mbajtur diskutime publike për 13 dokumente të politikave publike të komunës, ku është rritur pjesëmarrja e qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile sidomos për çështje të rinisë por edhe në fusha tjera. Gjithashtu si pjesë e konsultimeve dhe dëgjimeve publike buxhetore për kornizën buxhetore 2016-2018 janë mbajtur gjithsejtë 8 takime me qytetarë nëpër shumicën e bashkësive lokale. Edhe gjatë gjithë këtij viti është vazhduar me transmetimin në kohë reale (Live) i të gjitha mbledhjeve të Kuvendit Komunal në radion lokale.

Qasja në Dokumente Publike. Në vitin 2015, përmes Zyrtarit për qasje në dokumente publike, janë administruar 7 kërkesa për qasje në dokumente publike, prej të cilave është lejuar qasje e plotë në të gjitha dokumentet e kërkuara.

Peticionet Në vitin 2015 fillimisht Këshilli i drejtorëve i Komunës së Vushtrrisë e më pas edhe Kuvendi Komunal ka shqyrtuar dy peticione të qytetarëve të Vushtrrisë.

Përdorimi i gjuhëve Megjithëse në vitin 2015 është shtuar dukshëm numri i dokumenteve të publikuara në gjuhën serbe në Ueb faqe zyrtare të Komunës, megjithatë mbetet ende për të punuar në publikimin e informatave në ueb faqe. Në vitin 2015 Komuna përmes një projekti të OSBE-së, ka angazhuar 15 zyrtarë në kurs intensiv në mësimin dhe përforcimin e gjuhës serbe, si dh anasjelltas 15 serbe të administratës komunale kryesisht që punojnë në Prelluzhë kanë ndjekur kursin intensiv të mësimin të gjuhë shqipe. Sipas një vlerësimi të jashtëm të një projekti të mbështetur nga USAID-i, organizata CSD në projektin “vrojteshi i heshtur”, thuhet se

përdorimi i gjuhës serbe nga administrata komunale në Vushtrri është i mirë dhe pjesëtarët e komunitetit serb mund të kryejnë shërbime në gjuhën e tyre.

Monitorimi i medieve – paraqitjet dhe publikimet në medie Gjatë këtij viti është vazhduar me mbajtjen e raporteve profesionale me mediat të cilat kanë pasqyruar aktivitetet dhe ngjarjet e Komunës së Vushtrrisë, si mediat elektronike TV Kombëtare, radio, pastaj në gazeta, agjenci lajmesh si dhe portale.

## **Zyra për integritet Evropian**

Gjatë vitit 2015 Zyra për Integritet Evropian ka kontribuar në plotësimin e prioriteteve komunale që dalin nga „Planin e Veprimit për Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit për komunën e Vushtrrisë” të përgatitur nga MAPL-ja dhe “Udhërrëfyesin për Liberalizimin e Vizave”, me theks të veçantë në ri-integritetin e të kthyerve, monitorimin e organeve të administratës, integritetin e komunitetit RAE në sistemin arsimor, etj.

“Udhërrëfyesi për Liberalizimin e Vizave” - Të gjitha institucionet kanë marrë obligime të cilat kanë dalë nga ky udhërrëfyes. Përveç për nivelin qendror, detyra kanë dalë edhe për institucionet e nivelit lokal, përkatësisht komunat. Edhe pse udhërrëfyesi është publikuar në vitin 2012, sfidat që dalin nga ai ende nuk janë përmbushur plotësisht nga Republika e Kosovës, andaj edhe komuna e Vushtrrisë ka vazhduar në plotësimin e obligimeve komunale, ku obligimi kryesor i cili kërkohet nga komunat është ri-integriteti i personave të riatdhesuar. Në këtë drejtim Zyra për Integritet Evropian në bashkëpunim me Zyrën për Komunitete dhe Kthim kanë dhënë kontributin e tyre, duke bashkëpunuar edhe me MPB-në, ku përmes Komisioni Komunal për Ri-integritetin e personave të Riatdhesuar kanë mbështetur ri-integritetin e këtyre personave.

Zyra për Integritet Evropian Për çdo tre muaj iu ka përgjigjur pyetësorëve të dërguar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal për zbatimin e detyrave që dalin nga „Planin e Veprimit për Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit për komunën e Vushtrrisë”. Si dhe pyetësorit të dërguar nga MAPL-ja në fund të vitit në lidhje me obligimet komunal

## **Zyra ligjore**

Përfaqësuesi i autorizuar i komunës ka kryer këto punë dhe detyra të punës:

- Ka marrë pjesë në 91 seanca gjyqësore sipas ftesës së Gjykatës.
- Ka ushtruar 3 Padi dhe 13 përgjigje në padi,
- Ka ushtruar 8 Ankesa dhe 3 Kundërshtime,
- Ka ushtruar 2 propozime për përmbarim,
- Ka ushtruar 27 parashtrës të ndryshme ,
- Ka bërë përgatitjen dhe analizimin e lëndëve sipas nevojës.

Zyrtari i lartë Ligjor



Janë dhënë 17 rekomandime dhe opinione për çështje ligjore organeve të komunës dhe organeve të administratës komunale, Ka marrë pjesë në punën e komisioneve si: për vlerësimin, hartimin e draft rregulloreve dhe akteve tjera administrative si dhe në punën e komisionit për ankesa lidhur me dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës. Zyra Ligjore ka konstatuar dhënien e pronës së komunës në shfrytëzim, derisa prona ka qenë e uzurpuar nga personat e ndryshëm.

Zyra ligjore ka rekomanduar që pronat e palujtëshme të komunës mos të procedohen për dhënien në shfrytëzim derisa Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë të ofron dëshmi se prona është e lirë për dhënie në shfrytëzim. Si dhe Drejtoria për Arsim, Shëndetësi dhe për Administratë të kenë parasysh numrin e punëtorëve që pensionohen gjatë vitit kalendarik dhe efektet e mundshme financiare.

## **Sekretaria e Kuvendit**

Gjatë vitit 2015 Sekretaria e Kuvendit ka përgatitur dhe përcjellur ecurinë e punës së: Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë; Komitetit për Politikë dhe Financa; Komitetit për Komunitete; Komitetit Këshillëdhënës për Arsim, Kulturë, Fe, Sport dhe Rini; Komitetit Këshillëdhënës për Zhvillim Ekonomik dhe Shërbime Publike; Komitetit Këshillëdhënës për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit; Komitetit Këshillëdhënës për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale; Komitetit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore.

Gjithashtu ka përgatitur thirrjet (ftesat), ka proceduar materialet e pikave të rendit të ditës; ka hartuar procesverbalet për të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunës, komiteteve obligative dhe këshillëdhënëse; ka proceduar të gjitha rekomandimet e komiteteve obligative dhe konsultative tek organet kompetente; ka adresuar edhe pyetjet e anëtarëve të kuvendit për drejtoritë përkatëse. Gjatë vitit 2015 Sekretaria e Kuvendit ka materializuar këto akte: 85 Vendime, 11 Rregullore dhe Planin Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës.

Ka përgatitur po ashtu dhe ka përcjellur ecurinë e punës për 11 mbledhje të rregullta dhe një të jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës, pastaj për 12 mbledhje të rregullta të Komitetit për Politikë dhe Financa; për 11 mbledhje të Komitetit për Komunitete, si dhe për 13 mbledhje të mbajtura nga Komitetet Këshillëdhënëse.

## **Zyra Lokale e Komuniteteve**

Zyra Komunale për komunitete dhe kthim funksionon në kuadër të Administratës komunale. Qëllimi i punës së Zyrës komunale për komunitete dhe kthim është të shikojmë nevojat e komuniteteve pakicë që jetojnë në territorin e Komunës së Vushtrrisë. Shefi i ZKKK-së ka këshilluar autoritetet komunale në lidhje me problemet e komuniteteve pakicë të cilët jetojnë në territorin e Komunës, promovua të drejtat e tyre të barabarta në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve në Shërbimet Publike dhe për të krijuar kushte për kthim të qëndrueshëm personave të zhvendosur dhe riatdhesuar që i takojnë të gjitha komuniteteve. Puna e udhëheqësit të Zyrës Komunale për komunitete dhe kthim është përqendruar në ofrimin e ndihmës komunitetit jo shumicë, zgjedhjen e problemeve të tyre me të cilat ballafaqohen. Pjesëmarrja e rregullt në mbledhjet të cilat i përkasin problemeve të Komunitetit. Bashkëpunimi i rregullt

bashkëpunimi me Kryetarin e Komunës, drejtoritë komunale, Ministrinë për komunitete dhe kthim. Bashkëpunimi dhe kontaktet me të gjitha shërbimet në Komunën e Vushtrrisë, policinë e Kosovës KFOR-in, OSBE-në, UNHCR-në, UNDP-në, USAID-in, Organizatat Qeveritare dhe joqeveritare, pjesëmarrja në mbledhjet e të Komitetit për Komunitete Këshillit Lokal për Siguri Publike etj. Zyra Komunale për komunitete dhe kthim në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës dhe donatorët, kanë punuar për përmirësimin e infrastrukturës në Komunë (asfaltim të rrugëve, trotuareve, kanalizimit, ndriçimi rrugor etj.). Në bashkëpunim me Drejtorinë për Bujqësi ZKKK, ka punuar në pranimin e aplikacioneve për subvencione për bujqësi dhe perimkulturë.

Puna grupore e Komunës së Vushtrrisë dhe organizatës jo qeveritare “FODEM” (Forumi për zhvillim dhe demokraci) kemi punuar në hartimin e Strategjisë për komunitete jo shumicë në Komunën e Vushtrrisë 2016-2021. Është punuar në projektin për renovimin e zonës kadastrale e cila është kryer nga Agjencia Kadastrale e Kosovës. Në Komunën e Vushtrrisë është zbatuar projekti në zonën kadastrale në Novolan, Lumi i Madh). Roli i Zyrës Komunale për komunitete dhe kthim në këtë projekt ka qenë informimi i qytetarëve të komunitetit serb për realizimin e këtij projekti. Ka punuar në hartimin e Planit të Aksionit Lokal për Integrimin e Romëve, Ashkalive dhe Egjiptasve në Komunën e Vushtrrisë. Prandaj miratimin e kësaj Strategjie nga ana e Kuvendit të Komunës ka pasur nga zbatimi i saj. Rezultatet nga hartimi i Planit të Aksionit Lokal për integrimin e Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianët në Komunën e Vushtrrisë, janë ndërtuar dy shtëpi për komunitetin Ashkali në fshatin Stanovc i Poshtëm-Ultë . Zona e ndërtuar e banimit nga propozimi i ZKKK, Komuna e Vushtrrisë ka punuar me organizatën jo qeveritare Voice of ROMA. Së bashku me Drejtorinë e Kulturës, Sportit dhe Rinisë ka mundur shfaqje në gjuhën Rome me Radio Stacionin Lokal (kjo është e paraparë me Planin e Aksionit Lokal ).

Në fillim të vitit 2015, Komuna e Vushtrrisë papritmas e goditi migrimin e banorëve. Me rastin e kësaj ngjarjeje Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim çdo ditë ka bashkëpunuar me Ministrinë e Punëve të Brendshme. Duke pasur parasysh se shumica e tyre nuk kanë pasur dokumente të duhura ka pasur kthim i tyre. Personat e kthyer kanë kërkuar ndihmë nga Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim. Personat e kthyer kanë qenë të informuara nga ana e ZKKK, për procedurat dhe të drejtat e Rregullores për personat e riatdhesuar (Rregullorja nr. 08/2015 ).

Gjatë vitit të kaluar , kemi pasur bashkëpunim të mirë me USAID-in, në projektin “Avancojmë Kosovën së Bashku” rregullisht marrim pjesë në mbledhjet dhe seminarët e tyre.

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe Kryetari i Komunës, është duke punuar intensivisht për kthimin e personave të zhvendosur. Pos kësaj ne bashkëpunojmë me Ministrinë për Komunitete dhe Kthim. Gjatë vitit të kaluar kemi përpiluar listën prioritare për kthim dhe ndërtimin e shtëpive.

Gjate vitit të kaluar 2015 Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim ka punuar për qëllim që Komuniteti jo shumicë të jetë më afër institucioneve si në nivelin lokalë ashtu edhe në atë qendrorë.

Mirëpresim sugjerimet dhe propozimet eventuale që mund të paraqiten në rastin e shqyrtimit të këtij raporti.

Kryetari i Komunës - KKSB:  
Bajram Mulaku

